

1 E mërkurë, 21 korrik 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [Konferencë për Ecurinë e Çështjes]

4 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 14:30

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve, brenda
7 dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Z. Sekretar, ju lutem shpallni çështjen.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita. Kjo është
10 çështja me numër KSC-BC-2020-06, Prokurori kundër Z. Hashim
11 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Tani, ju lutem palëve dhe pjesëmarrësve që të prezantohen
14 duke filluar me zyrën e Prokurorit të Specializuar.

15 Znj. Prokurore, fjala për ju.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës dhe
17 të gjithëve. Për zyrën e Prokurorit të Specializuar sot ndodhen
18 Alan Tieger, Prokuror i Lartë, Ward Ferdinandusse, Shefi i
19 Hetimeve, Marlene Yahya Haage, Zyrtare Juridike dhe e Nxjerrjes
20 dhe unë jam Clare Lawson, Shefe e Zyrës Juridike.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Tani i kthehem
22 mbrojtjes. U lutem avokatëve që të prezantojnë ekipin e tyre,
23 duke filluar me -- nuk e di nëse është zoti Prosper apo?

24 Ju lutem, mund të flisni.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Shikojmë që ka problem me

1 audion. Mund të kemi probleme me mikrofonin por mund ta ketë
2 problemin mikrofonin. Ju lutem provoni mikrofonin tjetër.

3 Tani, po, dëgjohet. Për hir të transkriptimit nuk është
4 zoti Kehoe. Kërkojmë ndjesë për këto probleme teknike.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Më quajnë Luka Misetic, në emër të
6 zotit Thaçi këtu janë edhe bashkë-gjykatësit [siç u përkthye]
7 Sophie Menegon dhe bashkëpunëtorët juridikë, Bonnie Johnston
8 dhe nga larg janë bashkë-avokatët zoti Pierre Prosper dhe zoti
9 Dastid Pallaska. Faleminderit.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë zoti
11 Misetic.

12 Z. Emmerson.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Mirëdita,
14 i nderuar Gjykatës, edhe unë përshëndes të pranishmit në sallë
15 dhe jashtë saj. Jam Ben Emmerson që përfaqësoj zotin Veseli së
16 bashku me bashkë-avokatin, zotin Nick Kaufman.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Emmerson.
18 Tani, fjalën e ka zoti Young.

19 Z. YOUNG: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Mirëdita, i
20 nderuar Gjykatës, mirëdita të gjithëve. Për Z. Rexhep Selimi,
21 unë jam David Young. Faleminderit.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Young.

23 Tani ja jap fjalën zonjës Alagendra.

24 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes]
25 Mirëdita të gjithëve, përfaqësoj Z. Jakup Krasniqi, më quajnë

1 Venkateswari Alagendra, këtu paraqitem së bashku me bashkë-
2 avokatin, zotin Aidan Ellis dhe zotin Mentor Beqiri. Pra Aidan
3 Ellis dhe Mentor Beqiri.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Për hir të procesverbalit, dua të them se zoti Thaçi, zoti
6 Veseli, zoti Selimi dhe zoti Krasniqi nuk janë fizikisht të
7 pranishëm në sallë por na ndjekin përmes lidhjes me
8 videokonferencën.

9 Tani fjalën e ka mbrojtësi i viktimave, zoti Laws.

10 Z. LAWS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Mirëdita, i
11 nderuar Gjykatës, më quajnë Simon Laws, mbrojtës i viktimave në
12 këtë çështje.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Laws.

14 Tani i kthehem Zyrës Administrative.

15 ZYRA ADMINISTRATIVE: [Përkthim] I nderuar zoti Gjykatës,
16 në emër të Zyrës Administrative jam Stephan Wohlfhart, Zëvendës
17 Administrator dhe jam këtu së bashku me zonjën Fidelma Donlon,
18 Administratore e Gjykatës.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

20 Përpara se të vijomë me rendin e ditës, dua t'ju kujtoj
21 edhe një herë, nëse ndonjë prej palëve do të hasë vështirësi me
22 lidhjen nga larg, ju lutem na e bëni me dije menjëherë që ta
23 rregulloj, problemin.

24 Kalojmë tani te historiku procedural.

25 Më datë 12 korrik të vitit 2021 kam caktuar datën e kësaj

1 Konference të gjashtë mbi Ecurinë e Çështjes. U kam kërkuar
2 palëve që të paraqesin parashtime me shkrim, nëse dëshirojnë.

3 Më datë 16 korrik ZPS-ja, mbrojtja e zotit Thaçi, mbrojtja
4 e zotit Krasniqi, mbrojtësi i viktimave dhe Zyra Administrative
5 kanë paraqitur parashtimet e tyre me shkrim. I falënderoj
6 palët dhe pjesëmarrësit për parashkrimet me shkrim.

7 Në bazë të këtyre parashtimeve, unë e kam ndryshuar disi
8 rendin e ditës, për të përfshirë të gjitha temat e mëposhtme:
9 përditësim mbi mocionet paraprake; nxjerrje e materialeve;
10 nxjerrja e materialeve të marra gjatë kontrollimit dhe
11 sekuestrimit; kategorizimi specifik në këtë çështje në *Legal*
12 *Workflow*; dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me
13 kategorizimin sipas Rregullës 86(3) (b), pra përmbledhjes së
14 kësaj rregulle; lista e dëshmitarëve; përkthimet; statusi i
15 hetimeve të ZPS-së; statusi i hetimeve të mbrojtjes; pikat
16 juridike dhe faktike për të cilat palët pajtohen; mbajtja në
17 paraburgim; datën për konferencën e shtatë mbi ecurinë e
18 çështjes; dhe çdo çështje tjetër që palët dëshirojnë të ngrenë.
19 Qëllimi i seancës sot është që të shqyrtojmë ecurinë e kësaj
20 çështjeje dhe të diskutojmë për temat të cilat unë sapo i
21 përmenda.

22 Ju lutem palëve, si zakonisht, që të paraqesin pikëpamjet
23 e tyre në mënyrë koncize, për secilën temë, sipas kësaj
24 renditjeje.

25 Ju kujtoj pakëve që të na thonë paraprakisht nëse ndonjë

1 parashtrim kërkon nxjerrjen e materialeve konfidenciale, në
2 mënyrë që të kalojmë në seancë private apo të mbyllur.

3 Së pari, dëshiroj që t'i përditësoj palët mbi mocionet
4 paraprake, vendimet mbi mocionet paraprake, më saktë.

5 Do të nxjerr nesër dy vendime: së pari, një vendim lidhur
6 me mocionet që kundërshtojnë juridiksionin e Dhomave të
7 Specializuara, në përputhje me rregullën 97 (1) (a). Dhe së
8 dyti, një vendim mbi mocionet që pretendojnë mangësi në formën
9 e aktakuzës në përputhje me rregullën 97(1) (b). Secili prej
10 këtyre vendimeve del në përgjigje të disa mocioneve.

11 I informoj palët se çdo afat për kërkesat për të marrë
12 leje për të apeluar, do të zgjatet duke mbajtur parasysh
13 periudhën e pushimit të Gjykatës. Kjo do të përcaktohet në
14 vendim.

15 I informoj palët se do të nxjerr edhe një vendim të tretë
16 mbi prapësimet kushtetuese në gusht pas periudhës së pushimeve
17 të Gjykatës.

18 Të vijojmë atëherë me pikën e parë, sipas rendit të ditës
19 që ka të bëjë me nxjerrjen e materialeve. Së pari dëshiroj që
20 të dëgjojmë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar mbi progresin
21 e bërë lidhur me materialet provuese. Çfarë progresi është bërë
22 sa i takon nxjerrjes së materialit sipas Rregullit 102(1) (b)
23 nga ZPS-ja brenda afatit 23 korrik 2021. Në përputhje me këtë
24 afat i cili po afrohet, ç'pjesë e këtij materiali mbetet ende
25 pa u nxjerrë, pra që nuk është nxjerrë ende.

1 ZPS-ja a synon që të kërkojë masa mbrojtëse të tjera për
2 materialin shtesë sipas rregullit 102 (1)(b)? Cili është afati
3 realist nga ana e ZPS-së për të përmbushur detyrimet e veta për
4 nxjerrjen e materialeve sipas Rregullit 102(1)(b). Pastaj, a
5 është apo jo ZPS-ja në rrugë të mbarë sa i takon vendosjes në
6 dispozicion të mbrojtjes me një njoftim të hollësishëm të
7 provave që janë pjesë e objektit të Rregullës 102(3) brenda
8 ditës së premtë, 30 korrik të vitit 2021 dhe nëse mbeten ende
9 prova shfajësuese në zotërim, kontroll apo dijeni faktike të
10 ZPS-së dhe nëse këto kërkojnë masa mbrojtëse të afërta për këtë
11 material.

12 Në fund, nëse palët përballen me vështirësi sa i takon
13 procesit të nxjerrjes së materialeve sa i takon materialit të
14 Rregullës 107, dhe nëse tani së afërmi do të parashtrohet
15 ndonjë kërkesë lidhur me këtë.

16 Në veçanti duke pasur parasysh prezantimin e ZPS-së më
17 datën 16 korrik, dëshiroj të di numrin e kërkesave për ndryshim
18 që synon të dorëzojë ZPS-ja dhe kur, një grafik kohor të
19 arsyeshëm për parashtrimin e kërkesave ende të parashtruara
20 sipas Rregullës 107 dhe në fund, numrin e përafërt të raporteve
21 të ekspertëve që mbetet për t'u finalizuar.

22 Siç është përmendur në parashtrimin e ZPS-së, janë shumë
23 tema.

24 Ja jap fjalën ZPS-së pas së cilës do ta marrë fjalën
25 mbrojtja.

1 Zonja prokurore fjala është për ju.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

3 Siç e kemi thënë në parashtimet tona me shkrim, ZPS-ja
4 vijon të jetë në ecuri të mirë në përputhje me nxjerrjen sipas
5 Rregullës 102(1)(b). Pas Konferencës së fundit mbi Ecurinë e
6 Çështjes, dhjetë paketa të mëtejshme të materialeve të
7 Rregullës 102(1)(b) janë nxjerrë. Janë paketat 37, 38, 40, 41,
8 42, 43, 44, 46, 48 dhe 49.

9 Gjithashtu, janë dorëzuar edhe dy kërkesa shtesë për masa
10 mbrojtëse, më datë 4 qershor dhe 8 korrik, përkatësisht.

11 Paketat e mëtejshme të Rregullës 102(1)(b) janë në
12 përpunim e sipër dhe do të nxirren këtë javë. Pjesa më e madhe
13 e këtyre paketave të mbetura kanë të bëjnë me deklarata të
14 mëparshme, që kishin mbetur pra nga përpara, që lidhen me
15 provat materiale, pra këto pjesë këto materiale, që janë
16 përmendur edhe në parashtimin e mbrojtjes së zotit Thaçi në
17 fakt do të nxirren këtë javë, në varësi të problemeve që kanë
18 të bëjnë me masat mbrojtëse. Sa i takon nxjerrjes së
19 materialeve të tjera që kanë mbetur ende për t'u nxjerrë sipas
20 grafikut, ZPS-ja do ta ketë nxjerrë në përgjithësi materialin e
21 Rregullës 102(1)(b), në varësi të një numri të kufizuar të
22 përjashtimeve diskrete që janë përshkruar në parashtimet tona
23 me shkrim dhe që sapo i ka përmendur i nderuari Gjykatës.

24 Siç është vërejtur më tej në parashtimet tona me shkrim
25 ka pasur një kërkesë shtesë për masa mbrojtëse, e cila pritet

1 në fakt, ne e prisnim që të parashtrohej dhe do të dorëzohet
2 shumë shkurt nesër. Kjo ka të bëjë kryesisht me provat
3 materiale të lidhur me dëshmitarët për të cilët janë kërkuar
4 masa mbrojtëse dhe janë miratuar këto masa mbrojtëse.

5 Krahës kësaj, ne kemi mbajtur shënim vendimin e të
6 nderuarit Gjykatës mbi kërkesën e shtatë për masa mbrojtëse,
7 siç edhe ne jemi njoftuar sot paradite dhe në bazë të këtij
8 vendimi procedural, ZPS-ja kërkon autorizim që të bëjë një
9 kërkesë të mëtejshme për përdorimin e redaktimeve jo standarde
10 mbi deklaratat e mëparshme dhe provat materiale të lidhura me
11 këtë dëshmitarë, për të cilin janë kërkuar ose autorizuar masa
12 mbrojtëse.

13 Shqyrtimi i këtyre materialeve ka përfunduar dhe janë të
14 gatshme redaktimet. Ka pasur një vëllim shumë të madh provash
15 të lidhura materiale, rreth diku te 2300 materiale të tilla. Jo
16 të gjitha nga këto kanë nevojë për redaktime. Por si pasojë e
17 vëllimit, shqyrtimi i këtyre ka përfunduar vetëm kohët e
18 fundit. ZPS-ja nuk ka pasur mundësi që të parashtrojë një
19 kërkesë në lidhje me këto materiale deri tani.

20 Edhe pse vetë këto materiale janë të gatshme, do të duhet
21 një farë kohe për të përgatitur kërkesën për Gjykatën. Duke
22 pasur parasysh edhe afatet që kanë të bëjnë me çështjen dhe
23 periudhën e pushimit të Gjykatës, ZPS-ja do të bëjë një
24 kërkesë, më saktë ZPS-ja bën një kërkesë për zgjatjen e afatit
25 deri në datë 27 gusht, për të bërë pra një kërkesë të

1 mëtejshme.

2 Gjithashtu, një sfidë kryesore me nxjerrjen e materialeve
3 këtë javë, është teknike. Ne po hasim në vështirësi mjaftë të
4 konsiderueshme sa i takon nxjerrjes së materialeve në *Legal*
5 *Workflow*. Një shembull ka të bëjë me parashtrimin e
6 protokolluar tonin javën që shkoi.

7 Pas të hënës në mbrëmje, pra pas nxjerrjes së paketave, ka
8 pasur një vonesë të konsiderueshme të nxjerrjes për të kaluar
9 ky material. Të paktën në një rast, një paketë u zhduk nga
10 sekuenca e nxjerrjeve dhe krahas kësaj, pak kohë pas orës 7,
11 dje në mbrëmje ne nuk patëm më mundësi të hymë në sistemin
12 *Legal Workflow*.

13 I nderuar Gjykatës, palët mund ta kenë parë njoftimin e
14 shërbimit informatik sot paradite që bënte të ditur një restart
15 të serverit të *Legal Workflow* dhe shërbimi i plotë tashmë është
16 rivendosur vetëm sot paradite.

17 Shpresojmë shumë që të vijojmë me nxjerrjet e tjera të
18 parashikuara dhe do t'ju raportojmë për secilin prej këtyre
19 problemeve në momentin që këto probleme dalin. Dhe e
20 falënderojmë shumë Zyrën Administrative për disponibilitetin
21 dhe reagimin e tyre të menjëhershëm në përgjigje të këtyre
22 çështjeve, probleme të cilat kanë penguar disi nxjerrën këtë
23 javë. Sa i takon Rregullës 102(3), ne si ZPS jemi në ecuri të
24 mirë për t'i vendosur në dispozicion mbrojtjes njoftimin e
25 Rregullës 102(3) brenda datës 30 korrik. Ky njoftim do të bëjë

1 të ditur edhe materialet e mbetura që ka në zotërim ZPS-ja, që
2 kanë rëndësi të mundshme për këtë çështje dhe të cilat nuk i
3 janë nxjerrë palës ose në bazë të Rregullës 102(1) apo 103.

4 ZPS-ja do t'i bëjë një kërkesë të shkurtër Dhomës në
5 lidhje me këtë listë, në veçanti lidhur me pikat për të cilat
6 nuk është marrë ende miratim.

7 Sa i takon materialit të Rregullës 102(3), pas Konferencës
8 së fundit për Ecurinë e Çështjes, katër paketa me nxjerrje
9 materialesh mundësisht shfajësuese, janë nxjerrë në bazë të
10 Rregullës 102(3). Kjo përfshin edhe paketën 45, një paketë që
11 përmban elementë mundësisht shfajësuese të përmendura në
12 parashtrimin e mbrojtjes së zotit Krasniqi. Pra, është bërë
13 edhe kjo nxjerrje tashmë. Nuk ka masa mbrojtëse të cilat priten
14 tani së afërmi lidhur me shqyrtimin që i kemi bërë këtij
15 materiali.

16 Sa i takon Rregullës 107, ZPS-ja vijon që të punojë nga
17 afër me organizatat ndërkombëtare për të marrë miratimin e
18 tyre, qoftë edhe për të parë se cilat janë masat kompensuese.
19 Ne deri tani kemi filluar që të bëjmë disa kërkesa shumë
20 diskrete Gjykatës në lidhje me këto materiale. Siç e përmenda,
21 mendoj që do të bëjmë edhe një kërkesë tjetër në bazë të
22 Rregullës 102(3) dhe të njoftimit që del për këtë rregull.

23 Sa i takon çështjeve specifike që ka ngritur i nderuar
24 Gjykatës, sa i takon materialeve që kanë mbetur, ende pa
25 nxjerrë, dhe që ka një sërë kërkesash ndryshimi që do të bëhen

1 apo jo dhe kur do të bëhen, këto kërkesa për ndryshim u janë
2 bërë institucioneve dhe paneleve përkatës. Siç mund të keni
3 parë në aneksin e parashtimit tonë, pra bëhet fjalë për një
4 numër diskret çështjesh dhe për disa prej tyre kërkesat për
5 ndryshim janë miratuar për një numër jo të vogël të tyre.

6 Për kërkesat e tjera që kanë mbetur ende pa marrë
7 përgjigje ne nuk mund që të japim ndonjë mendim sepse është
8 jashtë kontrollit tonë. Nuk e dimë se kur do të merret vendim
9 për to. Ka një shkallë ndërgjyqësie që është në proces e sipër
10 për nja dy prej tyre por siç kemi përcaktuar edhe në
11 parashtimin tonë me shkrim, këto janë çështje relativisht
12 diskrete. Kur është e mundur është bërë -- po japim, po bëjmë
13 nxjerrje tashmë me versionet të ngjashme apo të redaktuara. Sa
14 u takon marrjes së miratimeve edhe këtu bëhet fjalë për një
15 vëllim shumë të kufizuar materialesh. Janë pesë, afërsisht pesë
16 dëshmitarë ndërkombëtarë, për të cilët nuk janë marrë ende
17 miratimet. Kur bëmë parashtimin tonë të premtën që shkoi numri
18 ishte gjashtë, por duke qenë se morëm miratimin -- ne morëm
19 miratimin por nuk morëm deklaratën e nënshkruar në një format
20 të lexueshëm. Pra numri i përafërt është pesë për të qenë të
21 saktë, aktualisht.

22 Krahës kësaj, ka edhe një numër relativisht të vogël
23 materialesh shkresore. Besoj se janë më pak se 50.

24 Sa i takon dorëzimit të tyre edhe kjo është disi jashtë
25 kontrollit tonë për t'ju dhënë një afat specifik për këtë, por

1 do të vijmë në mënyrë konstante -- disa prej tyre vijojnë që të
2 vijjnë edhe tani që flasim.

3 Sa i takon raporteve të ekspertëve, numri i ekspertëve në
4 fjalë është tre dhe ka të bëjë me materiale kriminalistike, siç
5 kemi thënë në parashtrimin tonë. Ndërkohë që materiali faktik
6 bazë për të cilin do të bëhen këto akt-ekspertiza, është duke u
7 nxjerrë brenda afatit këtë javë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
9 Prokurore.

10 Të fillojmë tani me mbrojtjen duke filluar nga zotin
11 Misetic.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Ne jemi në dijeni të
13 angazhimit të ZPS-së që të dorëzojë materialet sipas Rregullës
14 102(1)(b) deri të premten dhe kemi marrë qindra dokumente me sa
15 di unë dhe këto na janë dhënë disa orë përpara kësaj Konference
16 për Ecurinë e Çështjes, kështu që nuk kemi pasur mundësi t'i
17 shikojmë ende. Për sa i përket materialeve që kanë të bëjnë me
18 kërkesat për masa mbrojtëse, ne e dimë që ju keni dhënë afatin
19 4 qershor për të bërë këto aplikime. Disa prej këtyre
20 aplikimeve apo kërkesave kanë të bëjnë edhe me materialet,
21 parashtrimet që janë dorëzuar kohët e fundit dhe me dëshmitarë
22 që nuk janë nxjerrë më parë.

23 Me sa dimë ne ose me sa morëm vesh nga avokatja e
24 Prokurorisë, këto materiale do të jenë subjekt i kërkesave në
25 të ardhmen. Këto ende nuk janë nxjerrë por ne shprehim

1 shqetësimin tonë për dëshmitarët e ardhshëm shtesë të cilët do
2 të na jepen, për të cilët do të kërkohen masa mbrojtëse, pas
3 datës 4 qershorit.

4 Për sa i përket raporteve të ekspertëve, ne duam të
5 shprehim çudinë tonë që ende janë në përgatitje këto raporte
6 ekspertësh. Ju, i nderuar Gjykatës, në nëntor ZPS-ja tha që nuk
7 kishte asnjë lloj arsyeje se pse të mos fillonte gjyqi këtë
8 muaj dhe tani po na thuhet që janë ende në përgatitje tre
9 raporte ekspertësh dhe nuk do të jenë gati për afatin e
10 përcaktuar. Ne ju kërkojmë, i nderuar Gjykatës, që të
11 përcaktoni një afat të përcaktuar për çfarëdo raporti që do të
12 dorëzohet dhe që do të përdoret në këtë çështje, që ato të jenë
13 të përfshira në dosjen paraprake të Prokurorisë në mënyrë që
14 mbrojtja të jetë plotësisht në dijeni të provave që do të
15 dorëzohen ose që Prokuroria ka ndërmend t'i paraqesë.

16 Po kështu, disa nga këto materiale, ZPS-ja do të kërkojë
17 që të nxjerrë dokumente të plota deri në fund të gushtit. Për
18 sa i përket këtyre, u caktua njëherë data fundi i majit,
19 pastaj data u shty për në fund të kësaj jave dhe tani do të
20 shtyhet edhe më shumë, do të kërkojë edhe një muaj tjetër deri
21 sa të na jepen këto prova. Duam të vë në dukje që edhe kjo ka
22 lidhje me parashtrimet tona dhe me përgatitjet që do të bëjmë
23 në të ardhmen.

24 Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Unë do të
2 ja lë fjalën zotit Kaufman, që të merret me çështjet e
3 nxjerrjes së materialeve.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kaufman.

5 Z. KAUFMAN: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Siç thuhet
6 në Rregullën 96(1), qëllimi i Konferencave për Ecurinë e
7 Çështjes është që të sigurojë që përgatitjet për gjykim të jenë
8 fillohen dhe të bëhen në kohën dhe në mënyrën e duhur. Unë
9 kërkoj ZPS-së që të veprojë në mënyrë të zellshme. Nuk është
10 kjo një mënyrë e zellshme e kryerjes së punës. Është një mënyrë
11 -- dhe ata janë pushtuar nga paniku dhe po na dorëzojnë
12 materiale siç u vijnë.

13 Zonja Lawson sot paraqiti faktin që ka dorëzuar shumë
14 dokumente në bazë të Rregullës 102(1)(b), por ajo nuk e ka
15 përmendur që këto materiale u dorëzuan me 30 qershor. Kjo ishte
16 paketa 37. Pra, me fjalë të tjera, larg syve larg zemrës, si i
17 thonë asaj. Në qoftë se nuk është Gjykatësi që kërkon
18 Konferenca për Ecurinë e Çështjes për t'ju kërkuar llogari, ato
19 nuk bëjnë asgjë.

20 Për sa i përket dorëzimit në kohën e duhur, ne kemi vënë
21 re se gjuha e përdorur nga ZPS-ja në materialin 398 është që të
22 -- e kanë bërë enkas në mënyrë të t'i lenë vetes mundësi që të
23 shtyhet edhe më tej afati përfundimtar.

24 Kjo është një mantra që e kemi dëgjuar vazhdimisht dhe
25 është përsëritur edhe sot.

1 Unë them që ky është një mjegullim i materialeve dhe i
2 parashtrimeve që e ka karakterizuar ZPS-në tërë kohën. Me 17
3 dhjetor 2020, faqja 199, përfaqësuesit e Prokurorisë përcaktuan
4 një afat në maj, pastaj një afat tjetër që u shty.

5 Është shumë e rëndësishme për të pasur procedura të drejta
6 dhe sidomos duke pasur parasysh që të paraburgosurit janë ende
7 në burg, këto ndryshime të afateve nuk janë të drejta. Ne
8 shpresojmë që ZPS-ja do të jetë në gjendje të sqarojë sot dhe
9 të na thotë nëse masat mbrojtëse të cilat i kanë kërkuar me 8
10 korrik të vitit 2021 dhe që ata janë në kundërshtim me
11 rregullat dhe me vendimin që është dhënë nga Gjykatësi në 12
12 mars të vitit 2021. Ky ka qenë parashtrimi numër 218 që i
13 kërkonte Prokurorisë t'i dorëzonte këto dokumente deri më 4
14 qershor.

15 Pra ju kërkojmë, i nderuar Gjykatës, që t'jua bëni të
16 qartë Prokurorisë që në qoftë se ata shkelin afatet, materialet
17 të cilat do të dorëzohen me vonesë, nuk do të pranohen.

18 Pra ata së pari, po flasin për kërkesat për ndryshimet e
19 masave. Çfarë janë këto kërkesa për ndryshime të vendimeve ose
20 të masave? Sa kërkesa të tilla janë bërë? Kur janë bërë?
21 Domethënë, kjo mënyrë opake dhe e paqartë e bërjes së kërkesave
22 dhe të parashtrimit të gjërave nuk është mënyra e duhur e
23 bërjes së kërkesave.

24 Së dyti, janë këto kërkesat për miratim të cilat ende nuk
25 janë dhënë. Materialet sipas Rregullës 107 nuk janë trajtuar

1 ashtu siç duhet. Pra janë marrë një numër -- janë konfiskuar
2 një numër materiale por ajo që dimë ne është se Prokuroria
3 thotë që po i trajton të gjitha këto çështje në mënyre shumë
4 vigoroze, në mënyre shumë të fuqishme, por ne po pyesim nga
5 Prokuroria që të na sqarojë se sa materiale ka sipas Rregullës
6 107, kur janë marrë këto materiale apo dokumente, numrin e
7 personave apo të institucioneve që kanë dhënë këto
8 informacione dhe çfarë masash kompensuese janë marrë prej tyre.
9 Kjo është një kërkesë që bëhet edhe më akute sepse Prokuroria
10 me sa duket nuk do ta përmbushi afatin që ka caktuar sipas
11 Rregullës -- për materialet që janë sipas Rregullës 107. Në
12 qoftë se ne do t'i përmbahemi rregullave atëherë këta
13 dëshmitarë nuk duhet të lejohet të japin dëshmi, sepse
14 Prokuroria ka bërë kërkesa për shtyrjen e afatit dhe kjo
15 kërkesë është krejtësisht e paqartë.

16 Për sa i përket raporteve të ekspertëve, nuk ka asnjë lloj
17 justifikimi që afati i dorëzimit të tyre të shtyhet përtej 23
18 korrikut 2021. Raportet e ekspertëve përmenden në Rregullën
19 101(1) (b) dhe kanë të njëjtin status si deklaratat e
20 dëshmitarëve.

21 Nuk ka ndonjë të drejtë ligjore që këto të dorëzohen më
22 vonë. Disponueshmëria e ekspertëve nuk do të kishte qenë
23 problem në qoftë se ZPS-ja do t'i kishte administruar siç duhet
24 burimet e veta.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Kaufman.

1 Do t'ju jap fjalën pasi të kenë folur edhe avokatët e tjerë të
2 Mbrojtjes.

3 Z. Young.

4 Z. YOUNG: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Në emër të
5 zotit Selimi ne i mbështesim të gjithë shqetësimet që janë
6 përmendur nga avokati i zotit Thaçi dhe i zotit Veseli. Unë
7 desha të përmend dy gjëra që kanë të bëjnë me nxjerrjen e
8 materialeve. Së pari është e vështirë mbrojtja të kuptojë se sa
9 materiale do nxirren në tërësi duke pasur parasysh se si janë
10 nxjerrë këto materiale një nga një dhe ne mendojmë që kemi
11 tashmë rreth gjysmën e numrit të përgjithshëm të dëshmitarëve
12 dhe duke pasur parasysh dhe redaktimet e mëdha që i janë bërë
13 dokumenteve dhe që i janë bërë aktakuzës.

14 Së dyti, ne duam që në gusht të shikojmë se ku jemi me
15 gjendjen duke pasur parasysh se gjoja do të përfundohet
16 dorëzimi i materialeve sipas Rregullës 102(1)(b). Na duhet një
17 listë paraprake e dëshmitarëve në mënyrë që ta bëjmë këtë gjë.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Young.

19 Zonja Alagendra.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Do
21 t'ia jap fjalën zotit Ellis për të trajtuar çështjen e
22 nxjerrjes së materialeve dhe të provave.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] I nderuar
24 Gjykatës, ne i kemi paraqitur disa nga parashtrimet tona me
25 shkrim sot. Për sa i përket çështjeve që dalin nga parashtrimet

1 e Prokurorisë sot në mëngjes. Janë dy gjëra që duam të ngremë.

2 Së pari, çështja e ekspertëve. Pika e fillimit, siç tha
3 zoti Kaufman, është që si Rregulla 149 edhe ajo 102(1)(b) e
4 blejnë shumë të qartë se raportet e ekspertëve duhet të nxirren
5 para datës përfundimtare të dorëzimit sipas Rregullës 102(1)(b)
6 dhe ajo që po kërkon Prokuroria sot është një shtyrje e afatit
7 më tej dhe çështjet që dalin prej kësaj janë se së pari: pse
8 nuk është bërë kjo kërkesë më parë? Me sa mund të shoh unë,
9 përveç një poshtë shënimi të parashtrimit me shkrim të
10 Prokurorisë, kjo çështja e provave që do të jepen nga
11 dëshmitarët ekspertë, nuk është trajtuar nga Prokuroria. Kjo
12 duhet të kishte qenë e qartë edhe më përpara, domethënë që kjo
13 kërkesë për shtyrje duhej të ishte bërë edhe përpara të
14 premtës. Dhe pika e dytë është: cila është e baza për kërkimin
15 e shtyrjes së afatit? Çfarë është bërë nga Prokuroria për të
16 marrë këto dëshmi nga dëshmitarët ekspertë më herët. Ne po
17 merremi ngjarje që kanë ndodhur para 20 vjetësh në rrethana që
18 janë bërë hetime për vite të tëra. Ne themi që nuk duhet të
19 ketë shtyrje të afatit.

20 Çështja e dytë është çështja e materialeve që kanë të
21 bëjnë me kontrollin --

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Më falni. Do të merremi me
23 këtë çështje në një pikë të veçantë të rendit të ditës. Po në
24 lidhje me këtë pikë, mund ta trajtoni më vonë. A keni diçka
25 tjetër për të shtuar ndaj këtyre që thatë, zoti Ellis?

1 Z. ELLIS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Jo.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë do t'i kthemi kësaj
3 pike mbas disa minutash.

4 Atëherë Prokuroria, a mund t'i përgjigjeni mbrojtjes ju
5 lutem?

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mbrojtja duket se është e
7 shkëputur nga procesi i nxjerrjes së materialeve që po bën
8 Prokuroria tani. Volumi i materialeve të nxjerra këtë javë
9 është më se i mjaftueshëm për t'i ndihmuar ata dhe për t'i
10 mbajtur ata të zënë për një kohë të gjatë. Këto nuk janë të
11 bazuara në realitet, kërkesat e tyre dhe Prokuroria po punon
12 brenda afateve që keni caktuar ju i nderuar Gjykatës dhe po
13 përpiqemi t'i përmbahemi atyre afateve. Për sa i përket kohës
14 së dorëzimit të materialeve dhe rrjedha e se si -- apo sekuenca
15 se si janë nxjerrë këto materiale, kjo lidhet me nevojat për
16 masa mbrojtëse, sepse këto masa mbrojtëse kërkojnë kërkesa
17 paraprake për masa mbrojtëse si dhe për punime të mëtejshëm dhe
18 për hapa përgatitorë.

19 Prandaj ZPS-ja ka punuar ndërkohë në lidhje me afatet për
20 dorëzimin e kërkesave për masa mbrojtëse. Kjo do të thotë që
21 disa materiale të tjera për të cilat nuk ishin parashikuar
22 kërkesa për masa mbrojtëse, duhet të prisnin për më vonë deri
23 sa të përpunoheshin, në mënyrë që të përmbusheshin afatet e
24 përcaktuara.

25 Kërkesa e tetë për masa mbrojtëse që u dorëzua në 8 korrik

1 ishte pas afateve që kishit përcaktuar ju i nderuar Gjykatës.
2 Megjithatë, ne nuk e kuptuam që afatet ishin përfundimtare dhe
3 kërkesa u bë në mundësinë më të parë të mundshme që mund të
4 bëhej.

5 Një faktor i vetëm që ka pasur ndikimin më të rëndësishëm
6 në lidhje me kohën se kur janë dorëzuar materialet, nuk bazohet
7 në kërkesat e Prokurorisë apo proceset e Prokurorisë. Ka të
8 bëjë edhe me kërkesat që ka bërë mbrojtja për kategorizimin e
9 mëtejshëm të materialeve. Këto dhe ju i nderuar Gjykatës, në
10 vendimin e kategorizimit, kërkon që t'i jepej më shumë kohë
11 kategorizimit të materialeve sipas Rregullës 102(1)(b) dhe siç
12 kemi parashtruar edhe më herët në njoftimin sipas Rregullës
13 102(3) dhe Rregullës 95(4), këto janë mjaft të varura nga
14 dorëzimi i materialeve sipas Rregullës 102(b).

15 Për sa i përket disa çështjeve të tjera unë do t'i
16 përgjigjem avokatëve mbrojtës kur t'i ngrenë ato çështje, unë
17 do t'i përgjigjem ndërkohë që i ngrenë ato çështje.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
19 Prokurore.

20 Një nga çështjet që kemi sot është si ta interpretojmë
21 Rregullën në mënyrë të konsiderueshme për materialet e
22 Rregullës 102(1) [siç u përkthye] dhe si ta interpretojmë
23 "shteruese" në listën që kam dhënë unë me kërkesa të ndryshme
24 për masa mbrojtëse.

25 Mbrojtja ka gjë për të thënë në këtë moment për temën e

1 përgjithshme të nxjerrje së materialeve?

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkurtimisht, do t'i përgjigjem me
3 respekt se ne nuk kërkojmë nxjerrje të materialeve që ta zëmë
4 veten me punë, ne duam materiale të cilat ne duhet t'i
5 kategorizojmë pasi të marrim të gjithë provat. Na duhet që për
6 hetimet tona të përcaktojmë përparësitë dhe jo ta zëmë veten me
7 punë. Po ka pasur vëllime të mëdha materialesh që na janë bërë
8 të njohura dhe ne e vlerësojmë por shumë prej tyre mund të mos
9 kenë ndonjë rëndësi për ne për punën që kemi bërë ne si
10 mbrojtje në përgjithësi.

11 Por thjeshtë nxjerrja e dokumenteve në letër nuk e ndihmon
12 mbrojtjen kur në fakt nuk kemi marrë të gjithë informacionin e
13 duhur siç e kemi vënë në dukje në parashtimin tonë me shkrim.
14 Sepse janë 102 dëshmitarë afërsisht, nga 200, për të cilët
15 s'kemi informacion. Dhe që mendojmë se na pengon shumë në
16 mundësitë që kemi për të kryer hetime dhe kësaj çështje do t'i
17 kthehem më vonë.

18 Një diçka tjetër që dua të them lidhur me kërkesat për
19 masat mbrojtëse të paraqitur në fillim të këtij muaji, ne
20 degjuam se është bërë kërkesa në mundësinë më të parë të
21 mundshme. Me sa shihet, mbrojtja nuk është në gjendje të
22 atestojë këtë gjë dhe ne ua lëmë juve të vlerësoni nëse kërkesa
23 është bërë vërtetë në mundësinë më të parë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Misetic.

25 Zoti Young dhe zoti Ellis kanë kërkuar fjalën. Zoti Young,

1 ju lutem.

2 Z. YOUNG: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes]

3 Faleminderit. Mbrojtësi i zotit Thaçi e ngriti çështjen që do
4 ta ngrija edhe unë prandaj s'po e përsëris. Faleminderit.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Young.

6 Z. Ellis.

7 Z. ELLIS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Shumë
8 shkurt. Nuk po dëgjoj një përgjigje të qartë se përse nuk janë
9 marrë apo trajtuar çështja e provave të ekspertit.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

11 Po i drejtohem Prokurorisë për të na dhënë përgjigje për
12 temën e raportit të ekspertëve.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Me kënaqësi do t'i përgjigjem i
14 nderuar Gjykatës. ZPS-ja ka bërë përpjekje të hershme për të
15 identifikuar dhe udhëzuar ekspertët, por patëm vështirësi në
16 lidhje me këtë dhe na u desh të bënim ndryshime veçanërisht,
17 për shembull, një nga ekspertët që kishim ndërmend të
18 udhëzonim, nuk ju dha miratimi për të dëshmuar në këtë proces
19 penal dhe siç thashë përpara, të gjitha materialet bazë mjeko-
20 ligjore mbi të cilat do të bazohen raportet, do të jepen si do
21 të bëhen të njohura sipas afatit të javës. E kemi fjalën për
22 tre raporte të ekspertëve që priten të nxirren po ashtu në
23 lidhje me të gjitha çështjet e tjera. Qoftë kërkesa për
24 ndryshim apo për miratim që kanë të bëjnë me pesë persona, pesë
25 individë, janë jashtëzakonisht kërkesa shumë të kufizuara nën

1 dritën e vëllimit të madh të çështjes dhe të atyre materialeve
2 që i janë bërë të njohur ekipit të mbrojtjes për t'i shqyrtuar.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zonja
4 prokurore.

5 Më herët ju thatë se 27 gushti do të ishte në fakt data
6 kur ju do të përfundonit nxjerrjen e të gjitha materialeve në
7 bazë të Rregullës 102(1)(b). Kështu është? Ju kam kuptuar
8 drejtë? Nëse jo, çfarë nuk jeni të sigurt se do të ishin në
9 gjendje t'i nxirrnit në këtë datë, sepse nuk varet vetëm nga
10 puna juaj, me sa kuptoj.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, 27 gushti ishte data kur ne
12 kërkojmë që bëjmë të bëjmë kërkesë për masa mbrojtëse nën
13 dritën e vendimit tuaj për masa mbrojtëse. Materiale të tjera
14 të Rregullës 102(1)(b) që i përmenda janë një numër materialesh
15 që varen nga ndryshimet dhe nga kërkesat për miratim, kështu që
16 unë nuk jam në gjendje tani t'ju them se kur do t'i marrim këto
17 miratime, por posa që materiali të vijë tek ne, ne do ta
18 nxjerrim menjëherë.

19 Kërkesa jonë është bërë në parashkrimet me shkrim sipas së
20 cilës, raportet e ekspertëve do të parashtrohen bashkë me
21 materialet sipas rregullës 95(4). Ne shpresojmë gjithsesi se
22 edhe materialet e tjera do të jenë nxjerrë në atë kohë duke
23 përfshirë edhe kërkesën për ndryshime dhe miratim.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mendoni se raportet e
25 ekspertëve mund të nxirren më herët se sa materialet e

1 Rregullës 95? E kam fjalën në shtator për shembull? Apo mos
2 vallë është tepër herët sipas afateve tuaja?

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk jam në gjendje të angazhohem
4 në këtë çast, pa i shqyrtuar rrethanat konkrete të ekspertëve.
5 Disa prej tyre kanë çështje me disponueshmërinë pra për kohën
6 që mund të punojnë me këto materiale. Nuk jam në gjendje, pra,
7 nuk mund të them dot në këtë moment se do të jemi gati për një
8 datë më të hershme.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pyetja e fundit. Sa për të
10 konfirmuar se lista sipas Rregullës 102(3) nuk do të kërkonin
11 ndonjë ndryshim të afatit që është në fakt 30 korrik. Do t'i
12 përmbaheni këtij afati?

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Po i drejtohem
15 ekipit të mbrojtjes tani.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Shumë shkurt, i nderuar Gjykatës.

17 Ne vazhdojmë të jemi të shqetësuar lidhur me nxjerrjen e
18 raportit të dëshmitarëve ekspertë. Supozohej se do të fillonim
19 gjyqin në korrik. Nuk është e mjaftueshme të them se materiali
20 bazë do t'i nxirret mbrojtjes. Pra unë nuk mund të jap një datë
21 hipotetike. Ju mund t'i nxirrni të gjithë raportet, të
22 autopsive, por mbrojtja nuk do të ketë mundësi t'i shohë të
23 gjitha këto raporte pa parë çështjen e Prokurorisë lidhur me
24 çdo viktimë. Pra nuk mund të na e vini barrën që të fillojmë
25 nga fillimi të shohim të gjithë materialin. Dua të shohim

1 akuzat, përpara se të mund të japim përgjigjen tonë. E di që
2 për aq sa mund të përdorim raportin e ekspertëve të Prokurorisë
3 ne do të përdorim raportet tona, ekspertët tanë për të
4 interpretuar këto dëshmi me qëllim për të qenë të gatshëm për
5 të bërë edhe ne pyetjet tona dhe kjo ndikon në gjithë
6 përgatitjet tona për të qenë gati për gjyq.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Misetic.

8 Nuk shoh ndonjë - Zoti Ellis.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes]
10 Faleminderit, shumë shkurt. Vetëm dy ditë kanë mbetur nga dita
11 kur prokuroria do të nxjerrtë raportin e ekspertëve po t'i
12 përmbahej afatit. Dhe tani kërkohet një zgjatje e afatit. Pra
13 pa na thënë se kur janë për përpjekjet për të identifikuar
14 ekspertë të rinj apo kur janë kontaktuar ekspertët e tjerë.
15 Ata vazhdojnë të punojnë tani me këtë raport ndërkohë që ka
16 vetëm dy ditë nga data kur ata duhet t'i kishin nxjerrë. Pra
17 ka një vonesë të dukshme për mendimin tonë. Ndërkohë që të
18 akuzuarit rrinë në paraburgim, nuk duhet të jepet zgjatja e
19 afatit përveçse në rast se ju keni ndonjë shpjegim që mund ta
20 keni dëgjuar deri tani.

21 Faleminderit, zoti Ellis.

22 Zonja Prokurore.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Sa për t'i kujtuar të gjithë
24 mbrojtësit lidhur me fazën e procedurave. Jemi në një fazë të
25 procedurës të procesit paraparak, pra Prokuroria e ka përmbushur

1 barrën e për të arritur deri në këtë fazë. Por nuk jemi ende
2 aty në fazën ku të jetë vendosur data e ndonjë gjyqi. Sugjerimi
3 që raportet apo materialet e tjera që mund të vijnë pak më pas
4 afatit 23 korrik, duke parasysh gjithë ato materiale që kemi
5 nxjerrë, ne mendojmë se nuk i shkaktohet asnjë dëm të akuzuarve
6 dhe nuk është e saktë të thuhet kjo kur jemi në fazën që jemi.
7 Për shembull ne nuk i kemi kërkuar të ndërmerren hapat që të
8 transferohet çështja, për shembull, në gjykatë. Për shembull,
9 zgjidhja e mocioneve paraprake përpara Panelit të Apelit është
10 me rëndësi.

11 Sugjerimi që çdo numër i materialeve të identifikuar të
12 cilët mund të vijnë më vonë se sa afati, nuk ndikon mendojmë ne
13 fatin e të akuzuarve.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zonja
15 Prokurore.

16 Po ju them palëve se dëshiroj që në fund të kësaj seance
17 të lëshoj një urdhër me gojë në lidhje me afatet e nxjerrjes së
18 materialeve.

19 Tani të kaloj tek një çështje tjetër që e ngriti mbrojtja
20 e zotit Krasniqi në parashtrimet e veta. Çështja që e preku
21 edhe zoti Ellis pak më përpara, që ka të bëjë me nxjerrjen e
22 materialeve të sekuestruar gjatë kontrollit dhe sekuestrimit të
23 kryer në nëntor të vitit 2020. Së pari dua të dëgjoj nga
24 mbrojtja e zotit Krasniqi për kërkesën e saj për materiale të
25 tilla, në veçanti kërkesa që nxjerrja a materialeve nga

1 kontrolli të bëhet brenda 7 ditësh.

2 Zoti Ellis.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] I nderuar
4 Gjykatës, dhe morëm një paketë me materiale që përmban disa
5 dokumente që thuhet se janë marrë nga kontrolli që iu bë pronës
6 së zotit Krasniqi. Nuk e dimë nëse ato përfaqësojnë të gjitha
7 materialet shfajësuese të marra gjatë atij kontrolli. U nxor
8 edhe një paketë tjetër me materiale të Rregullit 102(1)(b) që u
9 tha se kanë dalë po nga ai kontroll. Të marra së bashku duket
10 se ato përfaqësojnë vetëm një fraksion të vogël të atyre
11 dokumenteve që u tha se janë gjetur gjatë kontrollit. Por para
12 se të shohim materialet e Rregullës 102(3) është herët për ne
13 të bëjmë komente. Pra ne kemi marrë disa materiale shfajësuese
14 dhe. Nuk e dimë ende se ç'ka mbetur për t'u nxjerrë.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Ellis.

16 Përpara se t'ja jap fjalën Prokurorisë, ka njeri nga
17 mbrojtja që do të shtojë ndonjë gjë për këtë temë? Jo.

18 Atëherë zonja Prokurore e keni fjalën ju.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, dy dokumente me materiale të
20 sekuestruar janë nxjerrë. Një është paketa 44, në bazë të
21 Rregullës 102(1)(b), tjetra është paketa me materiale 45, e
22 nxjerrë në bazë të Rregullës 103.

23 Kjo paketë në bazë të këtij rregulli, 103 pra, përmban të
24 gjitha materialet që deri tani i kemi identifikuar si materiale
25 shfajësuese nga materialet që u morën gjatë kontrollit.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

2 zoti Ellis.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Do të thotë
4 kjo se vlerësimi vazhdon lidhur me natyrën shfajësuese të
5 këtyre dokumenteve apo gjithçka është bërë dhe ne kemi
6 gjithçka?

7 Zonja Prokurore, sepse ju përmendët që në qoftë se e
8 lexojmë me saktësi transkriptimin se paketa në bazë të
9 Rregullit 102(3) përmban të gjitha materialet që deri më tani
10 janë identifikuar si shfajësuese. A mund ta shtjelloni më tej
11 deri më tani këtë pjese?

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, shqyrtimi është bërë dhe
13 materialet e identifikuara janë nxjerrë në këtë paketë me
14 materiale. Sigurisht, detyrimet në bazë të Rregullës 103 janë
15 detyrime që vazhdojnë për ne si Prokurori dhe ne do të
16 vazhdojmë të nxjerrim materiale. Pra është një ushtrim i
17 vazhdueshëm që ne duhet ta mbajmë në vazhdim. Pasi ta mbarojmë
18 shqyrtimin dhe pasi të identifikojmë ato materiale -- të gjitha
19 atë që kemi identifikuar deri tani nga sa dimë i kemi nxjerrë.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po për ato që s'janë
21 identifikuar si shfajësuese? E kam fjalën, në bazë të Rregullit
22 102(b) [siç u përkthye], në bazë të këtyre kontrolleve që nuk
23 janë nxjerrë ende?

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Materialet e Rregullit 102(1)(b),
25 pra paketa 44 përmban materiale të Rregullës 102(1)(b) nga këto

1 kontrolle. Afërsisht do të ketë 50 dokumente të tjera të cilat
2 do të përfshihen në paketën e ardhshme të nxjerrjes së
3 materialeve këtë javë.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
5 Prokurore.

6 Zoti Ellis, a morët përgjigje për pyetjen apo jo?

7 Z. ELLIS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Përgjigja
8 është për pjesën më të madhe të pyetjes. Ngelet faktikisht e
9 paqartë materialin e Rregullës 102(3).

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E saktë. Është ajo pjesë që
11 unë nuk mora. Çfarë është 103, çfarë nuk është 102(3)(b) do të
12 jetë në fund të javës tjetër?

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, do të
14 jetë. Janë 2300 elementë, materiale. Faleminderit.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
16 Prokurore.

17 Zoti Ellis.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes]
19 Faleminderit, i nderuar Gjykatës. Mbase kur ta marrim këtë
20 shqyrtim, mbase do të jetë diçka të cilës do t'i kthehemi në
21 Konferencën e ardhshme të Ecurisë së Çështjes.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Patjetër, ju ftoj që ta
23 përmendni në parashtimet tuaja për Konferencën e ardhme për
24 Ecurinë e Çështjes. Do të ishte e dobishme.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes]

1 Faleminderit, kështu do të bëjmë.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Ellis.

3 Tani dëshiroj të flasim për kategoritë në *Legal Workflow*
4 që janë specifike për çështjen, dhe të gjitha çështjet e tjera
5 të ngritura nga mbrojtja e Z. Krasniqi.

6 Së pari, lidhja me vendndodhjet, siç janë kategoritë në e
7 vendndodhjes në materialin e Rregullës 102(1)(a) dhe përcaktimi
8 i emrave të vendndodhjeve në lidhje me materialin e Rregullës
9 102(1)(b).

10 Së dyti, sa i takon lidhjes me dëshmitarët, në veçanti
11 mbrojtja e zotit Krasniqi kërkon që ZPS-ja të ndryshojë titujt
12 e dokumenteve në *Legal Workflow* për të përfshirë numrin
13 përkatës të dëshmitarit, ose si zgjidhje alternative, që ZPS-ja
14 të vendosë në dispozicion dhe të nxjerrë një paketë për secilin
15 dëshmitar që përmban të gjitha deklaratat apo intervistat, si
16 dhe dokumentet dhe provat materiale që janë përmendur nga
17 dëshmitari në këtë deklaratë a intervistë.

18 Krahës kësaj, mbrojtja e zotit Thaçi parashtroi se nuk ka
19 marrë të gjitha materialet e përmendura në deklaratat e
20 dëshmitarëve dhe intervistat e tyre.

21 Së treti, do të doja që të trajtonim nga ana e Mbrojtjes
22 së zotit Krasniqi versionin e përditësuar të përmbledhjes së
23 rregullës 86(3)(b).

24 Le të fillojmë me zotin Ellis, për problemet tuaja.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] I nderuar

1 Gjykatës, të gjitha këto problematika t'i përmend apo vetëm
2 përmbledhjen?

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Të gjitha.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes]

5 Faleminderit. Sa i takon problematikës së kategorizimit, siç e
6 dini situata është që Prokuroria ka përdorur kategorizimin për
7 materialin - për nxjerrjen e materialit 102(1)(b) që del në
8 *Legal Workflow*. Ajo që kemi dashur të arrijmë me këtë është se
9 nëse dikush do të donte të bënte ndonjë kërkim të dokumenteve
10 për një kategori të caktuar, do t'i nxirrte të gjitha këto
11 materiale nëse janë të lidhura me këtë kategorizim.

12 Kjo do të na ndihmonte jo vetëm ne, por çdo palë që mund
13 të bëjë punë kërkimore për këtë gjë, përfshirë këtu edhe Dhomat
14 në të ardhmen.

15 Aktualisht sistemi siç është nuk e arrin këtë gjë. Për
16 shembull në momentin që ne bëmë parashtimin tonë, 19
17 vendndodhje nuk kishin të lidhur me to asnjë dokument. Më duket
18 se është një përgjithësim dhe tani kanë mbetur 18 vendndodhje
19 për të cilat nuk është lidhur asnjë dokument në paketat e
20 nxjerrjeve.

21 Zgjidhja që do mendonim ne se do të ishte e saktë do të
22 ishte që edhe materialit i rregullës 102(1)(a) të kategorizojë
23 në të njëjtën mënyrë. Unë e kuptoj që kjo kërkon një farë
24 angazhimi nga ana e Prokurorisë por në parashtimin tonë do të
25 thoshim se do të ishte relativisht shumë pak në krahasim me

1 përfitimin që do të bëjë, sidomos kohën e parashikuar për
2 përmbledhjen dhe po kështu të shkurtonte shumë kohën e palëve
3 të tjera, përfshirë edhe ne.

4 Sa i takon përmbledhjes së përditësuar, kjo ka të bëjë me
5 një çështje që ne e kemi identifikuar kur kemi bërë një kërkim
6 në *Workflow* për një dëshmitar që ishte identifikuar në një
7 përmbledhje. Vetëm kur e morëm vesh që nuk ishte aty, morëm
8 vesh që ky dëshmitar është tërhequr, pra morëm vesh nga ZPS-ja
9 që ky dëshmitar është tërhequr. Dhe më pas u riklasifikua një
10 parashtrim i protokolluar dhe na u vendos në dispozicion, gjë
11 që e konfirmonte këtë.

12 Nëse ka ndryshime të tilla, do të donim që të vihem në
13 dijeni për këto. Nuk do të donim që t'i merrnin vesh vetëm duke
14 bërë kërkimet tona rastësisht.

15 Nëse nuk ka ndryshime të tjera, sigurisht nuk ka nevojë që
16 të përditësohet përmbledhja tani. Por nëse ka do të ishte me
17 rëndësi për përgatitjet tona që të vihem në dijeni.

18 Po kështu sa i takon aspekteve të tjera, ka të bëjë me
19 aspekte praktike të përdorimit të *Legal Workflow*. Nuk duam që
20 të interpretohet ky parashtrim i mbrojtjes, se mbrojtja kërkon
21 që të pengojë procesin, por në fakt bëhet fjalë për gjetjen e
22 mënyrave për ta përdorur materialin në atë mënyrë ku ekipet e
23 mbrojtjes të kenë mundësi ta përdorin që të eliminojmë
24 problemet të cilat i kanë identifikuar në Konferencat e
25 mëparshme për Ecurinë e Çështjes. Kur të nxirret një dokument

1 të lidhet me lehtësi me dëshmitarin apo dëshmitarin të cilin ka
2 lidhje. Prandaj ne propozojmë që paketat e nxjerrjes të bëhen
3 paketa të plota për dëshmitarët. Por kjo është propozuar më
4 përpara më duket edhe nga mbrojtja e zotit Thaçi.

5 Pra, ose të marrim një listë të dëshmitarëve të cilët do
6 të përdoren dhe deklaratat e dokumenteve paraprase të tyre të
7 jenë aty ose të paktën të marrim paketa nxjerrjesh të lidhura
8 me dëshmitarët.

9 Një mënyrë tjetër se si do të bëhej kjo ishte që të
10 vendosej edhe numri dëshmitarit. Nëse kemi të bëjmë me
11 dëshmitarë, identiteti i të cilëve nuk dihet, disa prej këtyre
12 deklaratave përshkruhen në *Workflow*, disa me numrin e
13 dëshmitarit, disa me emër apo me mbiemër, ndërkohë që numri i
14 dëshmitarit është unik. Do të preferohej, do thosha unë, numri
15 i dëshmitarit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Ellis.

17 Përpara se t'i jap fjalën ZPS-së a ka ndonjë ekip tjetër
18 mbrojtjeje që dëshiron të marrë fjalën?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, thjeshtë për të
20 theksuar që edhe mbrojtja e zotit Thaçi i mbështet këto
21 parashtrime. Faleminderit.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po zoti Kaufman?

23 Z. KAUFMAN: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Edhe ne i
24 mbështesim këto parashtrime.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Kaufman.

1 Zoti Young?

2 Z. YOUNG: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Edhe i
3 mbështesim këto parashtrime, sidomos parashtrimin që ka të bëjë
4 me një paketë për çdo dëshmitar. Pra një paketë për çdo
5 dëshmitar. Do të na e bënte jetën shumë më të lehtë. Dhe
6 sigurisht do të ishte një shembull shumë i mirë i menaxhimit të
7 çështjes gjyqësorë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

9 T'i kthehem tani ZPS-së për të gjitha këto kërkesa të
10 ndryshme, do të doja të fillonim me kategorizimin e materialeve
11 të Rregullës 102(1)(a) dhe pastaj me të gjitha kërkesat e
12 tjera.

13 Zonja Prokurore.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Sa i takon kërkesës për një nën
15 kategorizim të mëtejshëm të materialeve, së pari objekti i
16 nënkategorizimit të mëtejshëm që nevojitet për të mundësuar
17 shqyrtimin është diçka për të cilën ju i nderuar Gjykatës keni
18 marrë një vendim, pasi bëtë një peshim të kujdesshëm të të
19 gjithë faktorëve përkatës përfshirë këtu edhe rrjedhojat shumë
20 të rëndësishme për burimet edhe kohën që kërkon nën
21 kategorizimi, ndërkohë që mbrojtja ka një larmi instrumentesh
22 të ndryshme për kërkimin e materialeve. Po kështu duhet të
23 përmendim këtu edhe dobinë e kufizuar të një nën kategorizimi
24 të tillë.

25 Prandaj nuk ka bazë për ndryshimin e këtij vendimi

1 procedural që keni nxjerrë ju. Domethënë kategorizimi i bërë në
2 bazë të Rregullës 109(c) dhe urdhrit të të nderuarit Gjykatës
3 është thjeshtë një instrument ndihmues shtesë për të kërkuar
4 këto materiale.

5 Ishte një prej disa instrumentesh të tilla që e ndihmojnë
6 mbrojtjen që të shqyrtojnë materialet e nxjerra, përfshirë edhe
7 përmbledhjen e Rregullës 86 të cilën i nderuari Gjykatës e ka
8 njohur dhe pranuar si një udhëzues shumë të hollësishëm dhe të
9 kujdesshëm për materiale të Rregullës 102(1)(a), madje edhe
10 vetë zoti Emmerson e ka thënë edhe më përpara dhe duhet
11 theksuar se nën kategorizimet kanë një dobi të kufizuar. Ka një
12 udhëzues që ka përgatitur Prokuroria me urdhër të të nderuarit
13 Gjykatës për të ndihmuar më tej mbrojtjen.

14 Kjo sigurisht nuk mund të shërbejë si zëvendësues i
15 shqyrtimit të kujdesshëm që mund t'u bëjë vetë Mbrojtja
16 materialeve bazë dhe kërkimeve që ato bëjnë në *Legal Workflow*.

17 Nënkatëgorizimi i vendosur në dispozicion nuk është
18 shterues. Në këto nënkatëgorizime ZPS-ja ka qenë në dijeni që
19 elementet provuese shpesh lidhen me shumë aspekte të një
20 çështjeje kështu që lidhja me të gjitha prej këtyre ndonjëherë
21 është vështirë. Për pasojë nënkatëgorizimet e bëra në përputhje
22 me problematikat apo temat e mëparshme janë bërë në bazë të
23 lidhjes me to.

24 Po kështu përvoja deri tani ka treguar se nënkatëgorizimi
25 kërkon shumë burime dhe kohë të gjatë. Kjo ka qenë edhe arsyeja

1 kryesore që shpeshtësia e nxjerrjes së materialeve të Rregullës
2 102(1) (b) ka qenë faktori determinant lidhur me këtë. Nga
3 grafiku kohor i afateve të nxjerrjes që ka vendosur i nderuari
4 Gjykatës, ka përbërë dhe kriterin apo kërkesën për
5 nënkategorizimin në bazë të kërkesave të mbrojtjes. Kjo mbi të
6 gjitha, ka bërë që të ndryshohet edhe grafiku i afateve kohore.

7 Në fund edhe pse nuk është përmendur në parashtrimet e
8 deritanishme, mbrojtja e zotit Krasniqi ka bërë një pyetje sa i
9 takon vendndodhjeve të përfshira në nën kategorizimin dhe
10 vendndodhjet e identifikuara nga ZPS-ja dhe që janë vendosur në
11 dispozicion Zyrës Administrative për t'u zbatuar në *Legal*
12 *Workflow*, janë nxjerrë nga listat e bashkëlidhura aktakuzës.
13 Për kërkime të veçanta e ftojme mbrojtjen e zotit Krasniqi që
14 të na kontaktojë pas kësaj seance dhe me kënaqësi do t'i
15 trajtojmë këto.

16 Sa i takon pikës së dytë, kërkesa për një përmbledhje të
17 përgjithësuar, në fakt është e vërtetë që vetëm një incident
18 është hequr nga aktakuza përpara konfirmimit të akuzave dhe
19 provat përkatëse janë tërhequr.

20 Është incidenti që ka identifikuar ekipi i mbrojtjes së
21 zotit Krasniqi. Nuk ka ndryshime të tjera të ngjashme të cilat
22 do të kërkonin një përgjithësim të përmbledhjes.

23 Sa i takon kërkueshmërisë së materialeve në *Legal*
24 *Workflow*, mbrojtja e zotit Krasniqi vëren se kodet e
25 dëshmitarëve që janë në fushën përshkruese dhe jo në fushën e

1 titullit dhe që kjo cenon kërkueshmërinë. Ky është një problem
2 të cikin edhe ne vetë e kemi identifikuar në mars. Kemi bërë
3 një kërkesë që fusha përshkruese të shtohet në opsionet e
4 kërkimit në *Legal Workflow*. Duke qenë se mbeten ende pa marrë
5 zgjidhje një numër kërkesash për përmirësimin e *Legal Workflow*,
6 kjo është përcaktuar si prioritet nga ana jonë. Jemi në dijeni
7 që po punohet për këtë. Shpresojmë që të trajtohet së shpejti.
8 Ndërkohë ka një zgjidhje të përkohshme që ne e kemi
9 identifikuar vetë. Mund të eksportohet në format CSV që në
10 thelb nuk është gjë tjetër veçse një skedar në Excel nga *Legal*
11 *Workflow* dhe pastaj aty mund të bëhet kërkimi i kodit të
12 dëshmitarëve apo emri i dëshmitarit.

13 Nëse ekipet e mbrojtjes kanë vështirësi që të bëjnë një
14 eksportim të tillë në format CSV, jam e sigurt që shërbimi
15 informatik do të jetë në gjendje që t'i ndihmojë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
17 Prokurore.

18 Zoti Ellis?

19 Z. ELLIS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] I nderuar
20 Gjykatës, ne i qëndrojmë parashtrimeve që kemi bërë sa i takon
21 kategorizimit. Sigurisht do të duhet kohë por kjo kohë do të
22 ishte me përfitim për të gjithë ne.

23 Sa i takon përmirësimin e sistemit *Legal Workflow*, ne
24 mezi i presim këto përmirësime, nëse do vijnë. Nuk është vetëm
25 Prokuroria që ka vështirës në përdorimin e *Legal Workflow*. Ka

1 disa ditë që duket se ka probleme. Mbase kjo është shkaktuar
2 edhe nga vëllimi i materialeve që janë nxjerrë këto ditët e
3 fundit. Gjithsesi, e vërteta është që këto probleme mbeten.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Ellis.

5 Ndonjë ekip tjetër i mbrojtjes kërkon të marrë fjalën? Jo.

6 Për këto çështje unë mendoj se disa diskutime *inter-partes*
7 mund të ishin me dobi, siç ka sugjeruar Prokuroria. Zoti Ellis,
8 nëse jeni dakord mund të lidheni me Prokurorinë, më së shumti
9 për sa i takon përmirësimit të *Legal Workflow* dhe nxjerrjes së
10 dokumenteve nga *Legal Workflow*. Ftoj edhe Prokurorinë edhe ju
11 që në Konferencën e ardhshme mbi Ecurinë e Çështjes të më vini
12 në dijeni mbi progresin e bërë. Sigurisht çështja e materialit
13 të Rregullit 102(1)(a) është një diçka për të cilën unë duhet
14 të nxjerr një vendim procedural, por këtë do ta bëj për
15 Konferencën e ardhme mbi Ecurinë e Çështjes, pasi të jem i
16 informuar për këto diskutime *inter-partes*.

17 Vë re se është ora 4 pa 20 minuta, do të vijojmë me temën
18 e fundit për nxjerrjen dhe pastaj mbase mund të bëjmë një
19 pushim.

20 Kalojmë tani te kërkesa për listën paraprake të
21 dëshmitarëve. Çështja që do të diskutojmë tani është diçka e
22 cila është prezantuar nga Mbrojtja e zotit Thaçi në
23 parashtrimet përpara kësaj Konference mbi Ecurinë e Çështjes.
24 mbrojtja e zotit Thaçi ka kërkuar se duhet të përgatitur nga
25 ZPS-ja një listë paraprake dëshmitarësh së bashku me

1 përmbledhje të dëshmive që priten. Po kështu vërej edhe faktin
2 se mbrojtja e zotit Thaçi propozon dy data për vënien në
3 dispozicion të kësaj liste. I jap fjalën Z. MİSETIC për të
4 paraqitur argumentet e tyre.

5 Z. MİSETIC: [Përkthim] Faleminderit. Siç thatë edhe ju
6 kërkesa jonë ka të bëjë e dëshirën që të marrim konfirmim nga
7 Prokuroria lidhur me atë se për cilët dëshmitarë të cilët ka
8 bërë nxjerrje deri tani, kërkon që të thërrasë në gjykim apo të
9 cilët nuk do të dëshironte të thërrasë në gjykim apo që nuk ka
10 gjasa t'i thërrasë në gjykim. Sigurisht kemi dëshmitarë për të
11 cilët ZPS-ja ka marrë drejtpërdrejtë deklaratë dëshmitari dhe
12 ma merr mendja se ata do të dëshmojnë në këtë çështje
13 gjyqësorë, por ja edhe situata ku ne kemi marrë dëshmi në formë
14 transkriptimi nga procese jashtë këtij institucioni, e të
15 tjera. Nuk është e qartë nëse këta janë dëshmitarë të cilët
16 prokuroria dëshiron që të t'i thërrasë për të dëshmuar këtu,
17 apo t'i paraqesë si prova pa thirrur dëshmitarin në sallë. Disa
18 prej këtyre materialeve janë përshkruar si materiale
19 102(1)(a), disa të tjera si materiale 102(1)(b). Prandaj edhe
20 unë siç e thashë do të donim që të dinim nëse këta dëshmitarë
21 do të thirren nga Prokuroria për të dëshmuar në sallë apo jo.

22 Ne kemi nevojë që të vendosim përparësi në përgatitjet
23 tona dhe këtë e bëjmë duke ditur se cilët dëshmitarë do të
24 dëshmojnë në sallë në këtë proces gjyqësor. Prandaj propozojmë
25 që Prokuroria të përgatisë një listë për këtë qëllim.

1 Po kështu kemi kërkuar edhe nëse mund të na e nxjerrin një
2 listë paraprake të dëshmitarëve brenda datës 2 gusht, ku të
3 identifikohen dëshmitarët që është e sigurt që do të dëshmojnë
4 në sallë dhe një kategori e dytë ku të jenë dëshmitarët për të
5 cilët nuk ka siguri se do të thirren të dëshmojnë në sallë. Kjo
6 do të ishte.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti MISETIC.
8 Ka ndonjë ekip tjetër mbrojtjeje që do të marrë fjalën?

9 Zoti Young, ju lutem.

10 Z. YOUNG: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes]
11 Faleminderit, i nderuar Gjykatës, shumë shkurt. Në fakt, ky
12 është një sugjerim shumë i logjikshëm dhe i dobishëm për
13 menaxhimin e çështjes që e bën mbrojtja e zotit Thaçi. Nuk e di
14 nëse i nderuar Gjykatës ka punuar ndonjëherë për një ekip
15 mbrojtës, por vetëm në momentin kur mbrojtja është me saktësi
16 në dijeni se ku qëndron Prokuroria sa i takon dëshmitarëve dhe
17 provave të caktuara, mbrojtja mund të fillojë të punojë, se për
18 ndryshe mund të çojmë dëm një sasi të madhe kohe për të bërë
19 kërkime, analiza, përgatitje për persona të cilët Prokuroria
20 mund të mos t'i thërrasë fare për të dëshmuar këtu, apo që nuk
21 synon që t'i thërrasë këtu.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Young.
23 Zoti Emmerson, ju lutem.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Unë do të
25 thosha thjeshtë se e mbështesim kërkesën e bërë nga ekipi i

1 mbrojtjes së zotit Thaçi.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Emmerson.

3 Z. ELLIS, ju lutem.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] I nderuar
5 Gjykatës edhe ne e mbështesim këtë. Është një çështje e ngritur
6 edhe në Konferencat e mëparshme të Ecurisë së Çështjes dhe do
7 të ishte me shumë dobi për ekipet e Mbrojtjes për t'u
8 përgatitur për këtë çështje gjyqësorë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Ellis.

10 I jap fjalën Prokurorisë. Zonja Prokurore.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
12 Koncepti i listës paraprake të dëshmitarëve është një element
13 të cilin apo një teknikë që mbrojtja duket se e ka marrë nga
14 një çështje e paraqitur para Gjykatës Penale Ndërkombëtare të
15 quajtur, *Yekatom e të tjerë*. Në atë rast, është pranuar
16 shprehimisht se kërkimi i një liste të tillë në një çështje kaq
17 të jashtëzakonshme nuk ishte diçka e cila kërkohet në
18 përgjithësi. Lista paraprake e dëshmitarëve është kërkuar në
19 fakt me vendim procedural në çështjen *Yekatom e të tjerë*, po ka
20 qenë shumë -- për shkak të rrethanave shumë të veçanta të asaj
21 çështjeje në veçanti. Bëhet fjalë për majin e vitit 2020. Mu në
22 fillim të pandemisë së COVID-it me kufizime shumë të rrepta të
23 vendosura në atë rast, kështu që trupi gjykues në çështjen
24 përkatëse nuk patën mundësinë që të bënin Konferencën e parë
25 mbi Ecurinë e Çështjes me palët, mirëpo nuk jemi në këto

1 rrethana në këtë proces për të cilin jemi këtu.

2 Pra, kanë ndodhur edhe në rrethana kur objekti i akuzave
3 në *Yekatom* ishte si ngushtuar shumë në vendimin konfirmues. Por
4 edhe një herë, kjo nuk është një rrethanë të cilën e shohim në
5 procesin tonë.

6 Ajo që ka më rëndësi, bëhet fjalë për diçka e cila ka
7 ndodhur në një moment që ishte pesë muaj përpara momentit kur
8 pritej nga mbrojtja në çështjen *Yekatom* se do të bëhej nxjerrja
9 e materialeve nga Prokuroria. Dhe ishte një masë e përkohshme,
10 në rastin tonë mbrojtja ose e ka marrë ose do ta marrë gjatë
11 kësaj jave të gjithë materialin të cilin Prokuroria do ta
12 përdorë si bazë për provat e veta në procesin gjyqësor. Nuk ka
13 nevojë për masa të përkohshme kalimtare. Informacioni është
14 tashmë i disponueshëm dhe ZPS-ja ose i ka nxjerrë materialet e
15 dëshmitarëve ose do t'i nxjerrë, provat e të cilëve synon t'i
16 përdorë në gjykim.

17 Janë përmendur qindra dëshmitarë të mundshëm por kjo nuk
18 ka ndodhur në rastin tonë. Pra, për ta përmbledhur kjo kërkesë
19 që bëhet nga mbrojtja duket se është komplet jashtë kontekstit
20 dhe pa pasur parasysh veçantitë e çështjes sonë gjyqësore dhe
21 fazën më të avancuar të procesin në rastin tonë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
23 Prokurore.

24 Zoti Misetic, do të përgjigjeni?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, e kuptoj atë që po thotë

1 Prokuroria por nuk shoh asnjë arsye se pse e ka kaq të vështirë
2 Prokuroria po nuk shoh asnjë arsye sepse e ka kaq të vështirë
3 Prokuroria ta bëjë këtë.

4 Ata shpenzuan gjithë kohën e tyre duke shpjeguar se si
5 është çështja në Gjykatën Penale Ndërkombëtare por nuk na thanë
6 se çfarë dëshmitarësh kanë ndërmend që të thërrasin në Gjykatë.
7 Unë nuk e kuptoj se pse kërkohen kaq shumë burime për të
8 krijuar një listë të tillë dhe nuk është se lista që do të
9 paraqisnin është përfundimtare dhe nuk mund ta ndryshojmë. Kjo
10 është thjeshtë një udhëzues për mbrojtjen për mënyrën se si të
11 përgatisë çështjen. Pra ne e shikojmë që ata kanë nxjerrë shumë
12 materiale, por këto materiale në vetvete nuk na tregojnë se
13 cilët prej këtyre dëshmitarëve do të vijnë të dëshmojnë dhe
14 cilët prej tyre, të cilët janë të lidhur me deklarata që nuk i
15 janë dhënë Prokurorisë, po i janë dhënë institucioneve të
16 tjera, do të japin apo nuk do të japin dëshmi.

17 Pra, deri sa të na japin një arsye të fortë se pse nuk
18 mund të japin një listë të tillë, ne do të vazhdojmë ta
19 kërkojmë këtë listë.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Misetic.

21 Dëshironi të shtoni diçka, zonja Prokurore?

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Desha të them shumë shkurt, ky
23 material i është dhënë mbrojtjes, siç e thashë dhe këto nuk
24 janë lista të dëshmitarëve të mundshëm por këto janë lista të
25 dëshmitarëve në të cilët do të mbështetemi dhe do të paraqiten

1 në gjykim dhe nëse këta do të japin dëshmi nga salla e gjyqit
2 apo në një mënyrë tjetër, ky është një vlerësim që nuk mund ta
3 bëjmë në këtë moment.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Kaufman.

5 Z. KAUFMAN: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Unë do të
6 flas për rregullin 98 që flet për transmetimin apo kalimin e
7 dosjes paraprake Trupit Gjykues dhe siç e dini këtu Prokuroria
8 duhet të dorëzojë një dokument në Rregullën 98(1)(e),
9 nënseksioni (5) thuhet që aty duhet të ketë sugjerime në lidhur
10 me numrin dhe rëndësinë e dëshmitarëve që do të thirren. Pra
11 besoj që kjo është arsye e mjaftueshme që ta bëjë Prokurorinë
12 që të dorëzojë këtë listë.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zonja Prokurore.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, sa për t'ju përgjigjur kësaj,
15 unë do ta referoja mbrojtjen tek Rregulla 95(4) dhe aty mund të
16 shikojnë që listat jepen brenda afateve të përcaktuara dhe
17 mënyra e dhënies së dëshmisë jepet në atë kohë.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë nuk shikoj ndonjë
19 person tjetër që do të marri fjalën. Për këtë çështje do të
20 marrim një vendim më vonë.

21 Tani e shikoj që ora është 3:55, në qoftë se lejohet nga
22 përkthyesit atëherë mund të vazhdojmë edhe pak deri sa të
23 mbarojmë këtë pikë të agjendës.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit përkthyesve.

25 Tani të kalojmë te çështja e përkthimit të parashtimeve dhe të

1 materialeve provuese. Desha të dëgjoja së pari nga Zyra
2 Administrative në lidhje me përparimin e bërë me përkthimin e
3 këtyre dokumenteve dhe dua ta vë në dukje që njësia e
4 përkthimit ka ecur përpara me dokumentet e prioritizuara ndërsa
5 palët kanë bërë kërkesa më të hershme prioritare për përkthim.
6 Zyra Administrative ka mbaruar përkthimin e përmbledhjes së
7 detajuar të redaktuar dhe konfidenciale në bazë të Rregullës
8 86(3)(b), vendimin rreptësishtë konfidencial dhe versionin
9 konfidencial të redaktuar të vendimit të konfirmimit, dhe
10 dokumentet që ka kërkuar ekipi i mbrojtjes së zotit Krasniqi. I
11 vetmi dokument që ka mbetur që është përparësor është versioni
12 i redaktuar publik i vendimit të konfirmimit.

13 Po kështu shqetësimet e mbrojtjes së zotit Krasniqi në
14 lidhje me materialet që janë mbledhur dhe ende nuk janë
15 përkthyer dhe që mund të mbeten të pa përkthyer në të ardhmen.
16 Për shembull, nëse do të ketë në të ardhmen vendime në lidhje
17 me mocionet apo me mocionet paraprake.

18 Do t'ja jap fjalën një herë Zyrës Administrative për të na
19 përditësuar në lidhje me këto çështje.

20 Z. WOHLFHART: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës,
21 ju thatë tashmë që materialet janë vënë në dispozicion me 16
22 korrik, ajo është në paragrafin 214. Desha të them që të gjithë
23 këto dokumentet tashmë janë përkthyer në gjuhën shqipe, ka
24 ngelur vetëm në dokument i cili ende është i pa dorëzuar dhe ky
25 është versioni i redaktuar publik i vendimit për konfirmimin e

1 aktakuzës.

2 Njësia e përkthimit do të bëjë ç'është e mundur që ky
3 dokument të dorëzohet në fund të këtij muaji. Unë desha të
4 theksoj që ky dokument është vënë në dispozicion më 16 korrik,
5 por vetëm në versionet rreptësishtë konfidenciale dhe
6 konfidenciale të redaktuara.

7 Kjo më kthen te pika tjetër që të gjitha këto dokumente që
8 duhen dorëzuar të akuzuarve në gjuhët që i kuptojnë, përfshirë
9 edhe vendimin kuadër tuajin të nëntorit të vitit 2020. Të
10 gjithë këto vendime janë dhënë të përkthyer.

11 Ka disa çështje të tjera që kanë ngritur zoti Krasniqi, në
12 paragrafin 13 të parashtrimit të vet dhe përmend përkthimin në
13 gjuhën shqipe të disa vendimeve të Gjykatësë të Procedurës
14 Paraprake dhe të mocioneve paraprake dhe në përputhje me
15 rregullat tona të brendshme dhe me procedurat për përkthimin e
16 dokumenteve prioritare, ne jemi në dispozicion që ta diskutojmë
17 me palët këtë çështje. Faleminderit.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

19 Tani t'i kthehemi mbrojtjes. Ndonjë nga ekipet e mbrojtjes
20 ka diçka për të thënë. Zoti Misetic, doni të thoni diçka në
21 lidhje me këtë?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne nuk kemi ndonjë koment për këtë,
23 nuk kemi probleme me përkthimin.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Kaufman?

25 Z. KAUFMAN: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Për sa i

1 përket përkthimeve, zoti Veseli ka një vërejtje të
2 përgjithshme. Si një qytetar i Kosovës që po gjykohet në një
3 gjykatë që është pjesë e sistemit ligjor të Kosovës për krime -
4 megjithëse është për krime ai s'i ka kryer kurrë, zoti Veseli
5 insiston që t'i jepet çdo dokument në gjuhën shqipe. Kjo është
6 shumë e rëndësishme për qëllimin e kuptimit të vendimeve që
7 merr Gjykata dhe për qëllime operative.

8 Ne vëmë në dukje se sipas ZPS-së sipas paragrafit 4(d) që
9 materialet dhe parashtrimet duhet të bëhen -- dhe duhet të
10 jepen përkthimet e tyre sa më shpejtë që të jetë e mundur. Dhe
11 ne kërkojmë që të gjitha përkthimet të materialeve sipas
12 Rregullës 102(1)(b) duhet të na jepen shumë përpara se të
13 fillojë gjykimi. Pra ato deklarata të dëshmitarëve të cilat
14 janë vonuar dhe ende nuk i kemi përkthimet duam që ato të na
15 jepen menjëherë pasi të hiqen masat mbrojtëse për ata
16 dëshmitarë.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Sistemi i përkthimit,
18 regjimi i përkthimit është i përcaktuar në vendimin kuadër në
19 lidhje me nxjerrjen e provave dhe materialeve, kështu që i
20 kujtoj palëve që në qoftë se nuk janë dakord ose janë në
21 mospajtim me njëra tjetrën në lidhje me të, ata duhet të bëjnë
22 kërkesë për rishqyrtim të çështjes. Por në qoftë se një nga
23 palët nuk është dakord me këtë regjim të përkthimit që është
24 përcaktuar, mund të bëjnë parashtrime me shkrim.

25 Tani zoti Young, ju lutem.

1 Z. YOUNG: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Po, do të
2 bëjmë një parashtime shkrim në lidhje me atë që sapo thatë ju.
3 Në përgjithësi ne i mbështesim të gjithë parashtimet që bëri
4 mbrojtja e zotit Krasniqi në lidhje me përkthimin e
5 dokumenteve. Me respekt ju them, ky është një shqetësim shumë i
6 madh i mbrojtjes dhe do të jetë si thembra e Akilit edhe për
7 Gjykatën. Sepse nuk kemi bërë ende kërkesa prioritare ne si
8 mbrojtje e zotit Selimi, ende, dhe shpresojmë që nuk do të kemi
9 nevojë në të ardhmen por mbase të kemi qartësi më të madhe në
10 lidhje me materialet sipas Rregullës 102(1)(b) atëherë do t'i
11 tregojmë Gjykatës se çfarë do të kemi nevojë. Nën dritën e asaj
12 që ju sapo thatë i nderuar Gjykatës, ne presim që të ketë shumë
13 më tepër kërkesa për përkthime në gusht dhe në shtator, pra
14 është shumë e rëndësishme që Zyra Administrative të ketë
15 burimet e nevojshme. Ju i nderuar Gjykatës mbani mend që në
16 Konferencën unë zgjodha 1-2 dokumente që janë shumë të
17 rëndësishme dhe që këto dokumente po vonoheshin shumë: pesë -
18 gjashtë muaj ose shtatë muaj mbas arrestimit të të akuzuarve.
19 Unë nuk do t'i hyj këtyre në hollësi por unë i mbështes
20 parashtimet bëra nga zoti Krasniqi dhe nga zoti Veseli sepse
21 ne themi se është shumë e rëndësishme që të gjitha këto
22 dokumente të përkthehen në shqip sidomos për sa i përket
23 materialeve sipas Rregullës 102(1)(b) dhe 103. Në këtë fazë dua
24 të bëj një pyetje dhe a mund t'i pyesni përfaqësuesit e Zyrës
25 Administrative sepse unë dua të kuptoj tablonë e përgjithshme

1 për këto dilemat e përkthimit, këto probleme shumë, shumë të
2 mëdha. Në qoftë se Zyra Administrative ka informacion në
3 dispozicion do të ishte shumë e dobishme për ne që të dinim të
4 paktën përafërsisht se çfarë përqindje e materialeve sipas
5 Rregullës 102(1)(b) dhe 103 janë përkthyer, nga shqipja në
6 anglisht apo nga anglishtja në shqip, sepse ne kemi dyshim që
7 një përqindje e mirë e këtyre materialeve nuk janë përkthyer,
8 materiale të rëndësishme madje. Faleminderit.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Young.

10 Përpara se t'ja jap fjalën Zyrës Administrative, zonja
11 Alagendra apo zoti Ellis, ju lutem.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Ne i
13 bashkohemi vërejtjeve që bënë kolegët dhe parashtimet tona i
14 kemi bërë me shkrim.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] T'ia jap fjalën edhe zotit
16 Laws, në lidhje me çështjen e përkthimit, a keni ndonjë
17 parashtim që doni të bëni në lidhje me këtë çështje?

18 Z. LAWS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Jo, nuk kam.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Zëvendës Administrator,
20 në lidhje me çështjet që ngriti zoti Young apo parashtimet e
21 tjera që mund të bëni në lidhje me çështjen e përkthimit.

22 Z. WOHLHART, Faleminderit zoti Young për pyetjen, nuk kemi
23 statistika ende por kjo është një çështje që mund ta shikojmë
24 shumë shpejtë dhe t'ju raportojmë në lidhje me të.
25 Faleminderit.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, e shënova.

2 Atëherë a ndonjë parashtim tjetër në lidhje me këtë çështje?

3 Zonja Prokurore?

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës, ne po
5 vazhdojmë në përputhje me urdhrin tuaj të mëparshëm dhe po
6 marrim masat e duhura në lidhje me gjuhët e nxjerrjes së
7 materialeve. Faleminderit.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A ka ndonjë nga ekipet e
9 mbrojtjes që do të ngrejë ndonjë çështje? Jo. Atëherë do të
10 bëjmë një pushim tani, për 20 ose 25 minuta, do të vijmë
11 përsëri këtu në orën 4:30, ora e Hagës.

12 Të gjithë në këmbë.

13 --- Pushim merret në orën 16:06

14 --- Seanca rifillon në orën 16:29

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani t'i kërkoj ZPS-së
16 gjendjen se ku janë me hetimet, në veçanti nëse ZPS-ja mund të
17 na përditësojë për datën që mendojnë ata se do të përfundojnë
18 hapat hetimore dhe nëse afati i mesit të tetorit të vitit 2021
19 sipas tyre ende qëndron si afat për dorëzimin e dosjes
20 paraprake. Po kështu, ftoj ZPS-në të bëjë parashtimin në
21 lidhjen me kalendarin procedural. Desha të vë në dukje edhe
22 parashtimin e mbrojtësit të viktimave që do më shumë qartësim
23 në lidhje me kalendarin e këtyre procedurave dhe sidomos me
24 datën se kur mund të fillojë gjykimi dhe sa mund të zgjasë
25 gjykimi. Ndonëse kohëzgjatja e gjykimit nuk mund të përcaktohet

1 në këtë kohë, të gjitha çështjet e tjera mund të diskutohen.

2 Atëherë, ftoj Prokurorinë që të bëjë parashtimet e veta
3 në lidhje me hapat hetimore të saj dhe për mbylljen e hetimeve.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Hetimet e ZPS-së do të vazhdojnë
5 për të ardhmen e parashikueshme. Këto hetime do të kenë të
6 bëjnë edhe me çështje të tjera gjyqësorë, dhe hetime të tjera
7 që po bëhen dhe sidomos me këtë çështje të përcaktuar.

8 Është përgjegjësi e Zyrës së Prokurorisë të Specializuar
9 që të kryejë të gjitha këto hapa dhe s'ka asgjë të
10 jashtëzakonshme në lidhje me këtë. Dhe në kundërshtim me
11 parashtimet e mbrojtjes së Thaçit, këto nuk kanë asnjë lloj
12 ndikimi në të drejtën e zotit Thaçi për të ditur akuzat kundër
13 tij. Këto akuza janë të përcaktuara qartë në vendimin e
14 konfirmuar dhe Prokuroria mbështetet tek ato vendime për të
15 provuar çështjen e saj në gjyq.

16 Ekziston një kornizë ligjore që e përcakton këtë dhe ZPS-
17 ja është në dijeni të plotë se këto hetime të cilat po i kryen
18 dhe provat inkriminuese, i takojnë Trupit Gjykues për të
19 vendosur dhe vendimi do të merret në lidhje me shkallën e
20 paragjykitimit që do të shkaktojë apo të cenimit të të drejtave
21 të të akuzuarve që do të shkaktojnë këto.

22 Për sa i përket fazës së tanishme, në fazën e procedurës
23 paraprahe, ne kemi arritur në një fazë mjaft të përparuar të
24 saj dhe nuk është caktuar datë për fillimin e gjykitimit. Pra kur
25 të bëjë Prokuroria aplikim në lidhje me këtë çështje, atëherë

1 do të përcaktohet, duke përfshirë edhe fazën e procedurës se ku
2 do të jemi.

3 Në lidhje me materialet e Rregullës 95(4), siç kemi thënë
4 në parashtrimet tona me shkrim, nuk kemi ndonjë ndryshim në
5 pozicionin apo në vlerësimin e afateve kohore që ka dhënë
6 prokuroria. Megjithatë, kemi disa çështje që mbeten të cilat
7 mund ta vonojnë procedurën, sidomos sepse mund të ketë
8 konfrontime gjyqësore në lidhje me mocione paraprahe dhe varet
9 edhe nga kërkesat që do të bëjë mbrojtja në lidhje me
10 materialet e rregullës 102(3). Po kështu, ka edhe disa kërkesa
11 që kanë të bëjnë me ndryshimin e urdhrave dhe kërkesat që janë
12 bërë për miratime, shpresojmë -- këto janë çështje që janë
13 jashtë kompetencave tona, nuk varen nga por shpresojmë që do të
14 zgjidhen deri atëherë.

15 Për sa i përket materialeve të Rregullës 95, sidomos
16 listës së dëshmitarëve, dua të sqaroj diçka që thashë më parë,
17 përpara -- desha të sqaroj pra që ka disa dëshmitarë të
18 deklaratat e të cilëve ne do të mbështetemi, por ne nuk do t'i
19 thërrasim ata të japin dëshmi në gjykim dhe për këtë arsye nuk
20 kemi dhënë materiale të mëtejshme në lidhje me deklaratat e
21 mëparshme të këtyre dëshmitarëve, në materialet që kemi
22 dorëzuar sipas Rregullës 102(1)(b). Megjithatë, këta dëshmitarë
23 mund t'ia identifikojmë menjëherë mbrojtjes, nëse dëshirojnë.
24 Pjesa e materialeve të tjera, siç e thashë, kanë të bëjnë me
25 dëshmitarë të cilët Prokuroria do të mbështetet gjatë

1 gjykimit.

2 Në lidhje me pyetjet që bëri mbrojtësi i viktimave në
3 lidhje me datën e fillimit të gjykimeve, kjo është një çështje
4 për të cilën palët kanë bërë parashtime të gjerësishme.
5 Kërkesa e Prokurorisë është që gjykimi të fillojë tre muaj mbas
6 dorëzimit të materialeve sipas Rregullës 95(4) dhe kjo është në
7 përputhje me praktikën e përgjithshme në institucione të tjera
8 ndërkombëtare të këtij lloji. Pikërisht edhe në çështjen
9 *Yetakom* në të cilën u mbështet mbrojtja e zotit *Thaçi*, e njëjta
10 praktikë është ndjekur.

11 Palët kanë bërë parashtime në kundërshtim me njëra
12 tjetrën në lidhje me këtë çështje dhe këto janë shënuar në
13 procesverbalin, të gjitha parashtimet që janë bërë me shkrim
14 dhe ato që janë bërë me gojë në Konferencën për Ecurinë e
15 Çështjes. Megjithatë, ju i nderuar Gjykatës përcaktoni se cili
16 do të jetë procesi procedural në fazën paraprake dhe pastaj
17 Trupi Gjykses do të vendosi në lidhje me fazën pas kësaj.

18 Duke pasur parasysh materialet që ka marrë mbrojtja dhe
19 përvojën që kanë ata në lidhje me çështje të ngjashme në
20 institucione të tjera gjyqësorë ndërkombëtare, shpresoj që ajo
21 është bazë e mjaftueshme për të këshilluar klientët e vet.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mbrojtja.

23 Zoti Misetic.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Së pari t'i përgjigjem çështjes së
25 hetimeve në vijim si ne nuk jemi dakord me pozicionin e

1 Prokurorisë që mund të vazhdojë hetimet e veta në mënyrë të
2 pafundme. Ne jemi të mendimit se sipas Rregullës 4 të
3 Rregullores së Procedurës dhe Provave, thuhet që Kodi i
4 Procedurës Penale të Kosovës duhet të merret parasysh në
5 interpretimin e rregullores së Procedurës dhe Provave dhe sipas
6 nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, hetimet
7 penale duhet të përfundohen ta paktën dy vjet e gjysëm pasi të
8 kenë filluar hetimet. Unë nuk jam i sigurt nëse është ky forumi
9 i duhur ku mund të paraqesim mendimet tona të kundërta dhe të
10 debatojmë për këtë çështje.

11 Tani t'i kthehem pikës tjetër. Prokuroria tani thotë që
12 nuk ka ndryshime për sa i përket pritshmërive në lidhje me
13 kohën se kur do të dorëzojë materialet sipas Rregullës 95(4),
14 por sigurisht ka lloj-lloj cilësimesh të cilat duhet t'i vihen
15 kësaj deklarate, domethënë që mund që të interpretohen si një
16 mosangazhim i tyre për dhënien e këtyre materialeve në tetor
17 siç është parashikuar.

18 Ne duhet të kemi parasysh faktin që klientët tanë janë në
19 paraburgim në këtë kohë dhe nuk jemi në një pozitë që mund të
20 vazhdojmë vazhdimisht duke i shtyrë këto afate, ndërkohë që të
21 akuzuarit janë paraburgim. Pra, mendojmë që ekziston një
22 urgjencë që ZPS-ja t'i përmbahet këtyre afateve dhe t'i
23 përmbushë ato.

24 Dhe nuk duhet që Prokuroria të jetë në një pozicion që
25 mund të thotë: "Po ne nuk e premtuam këtë, që duhet t'i

1 përmbahemi detyrimeve të Rregullës 95(4) në tetor".

2 Së fundi, për sa i përket përgatitjes për gjykim, ne themi
3 se ka shumë materiale që ende nuk i kemi parë dhe Prokuroria
4 vazhdon të mos angazhohet në lidhje nxjerrjen e materialeve
5 sipas Rregullës 95(4) në tetor. Ende po përgatiten raportet e
6 ekspertëve. Ne akoma s'kemi filluar të përgatitemi dhe në këto
7 rrethana ne nuk jemi të përgatitur të themi se kur do të
8 përfundojmë dhe kur do të jemi gati.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Emmerson.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Unë sot
11 nuk kam ndërhyrë shumë në këto diskutime, por është e qartë se
12 cili është thelbi i parashtrimeve të mbrojtjes dhe çfarë
13 shqetësimesh kemi ne, që paraqesim Gjykatës dhe shqetësimi
14 është për mënyrën se si Prokuroria po vepron në këto procedura.

15 Unë desha të them në emër të Z. Veseli që sidomos nën
16 dritën e vendimit të fundit tuajt, i nderuar Gjykatës, që nuk i
17 keni dhënë lirim të përkohshëm, ai mendon në mënyrë të
18 arsyeshme që ai po mbahet peng. Ndërkohë që Prokuroria po
19 vazhdon të vonojë procesin e përgatitjes për gjykim.

20 E dyta, ndoshta do të donit që unë të trajtoj këtë çështje
21 kur të vijë puna për përgatitjen e mbrojtjes por për sa i
22 përket gatishmërisë për të filluar gjyqin dhe përgatitjes së
23 mbrojtjes, dua të di diçka nëse mund të ma sqaroni në lidhje me
24 vendimet që do të jepni nesër dhe në gusht, sepse këtyre
25 çështjeve mund t'u kthehem në atë kohë, pra.

1 Zoti Kaufman, do të trajtojë çështjet e mëtejshme.

2 Z. KAUFMAN: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Vërtetë që
3 Prokuroria mund të dojë të vazhdojë hetimet e veta dhe më tej
4 pafundësisht, por për sa i përket provave inkriminuese nga këto
5 hetime dhe dorëzimit të tyre jashtë afateve për nxjerrjeve të
6 materialeve, këto duhet të miratohen nga Gjykatësi. Dhe ne jemi
7 kundër kësaj.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Young.

9 Z. YOUNG: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Nuk kam
10 asgjë për të shtuar përtej atyre që tha mbrojtja e zotit Thaçi
11 dhe e zotit Veseli.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zonja Alagendra.

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Edhe
14 ne mbështesim pozicionin e zotit Thaçi dhe Veseli.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zonja Prokuror, doni të
16 përgjigjeni?

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Duket se palët nuk kanë ndonjë
18 mendim shumë të ndryshëm me njëri-tjetrin në lidhje me atë që
19 kam thënë më përpara. Ne e dimë se cili është vendimi kuadër
20 dhe materialet që dalin prej hetimeve në të cilat do të
21 mbështetemi, do të autorizohen nga Gjykatësi dhe e dimë, e
22 pranojmë të drejtën e mbrojtjes që të paraqesin argumentet e
23 veta në lidhje me to.

24 Sigurisht, ne jemi kundër asaj që tha mbrojtja e zotit
25 Veseli që është vonuar procesi përgatitjes së këtij gjykimi.

1 Përkundrazi, Prokuroria i ka përmbushur detyrimet e veta në një
2 mënyrë shumë të shpejtë dhe i është përmbajtur afateve që janë
3 dhënë.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
5 Prokurore.

6 Z. Emerson.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Kjo e
8 fundit që tha Prokurorja janë të gjitha gjepura, që ato janë të
9 -- ata thonë që ndoshta mund të jenë gati për gjykim sot. Fakti
10 është që ata po flasin për një gjykim që nuk mund të fillojë
11 deri në fund të vitit 2021 dhe ata nuk i janë përmbajtur
12 afateve. Pra unë mund të dëgjoj këtu parashtimet e bëra që
13 janë proporcionale të përshtatshme, të vërteta, por ky
14 parashtim që u bë këtu, nuk është një prej tyre.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Emerson.

16 Zoti Laws, a keni ndonjë diçka për të shtuar në lidhje me
17 këtë?

18 Z. LAWS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Unë i ngrita
19 këto pyetje sepse ato m'i kanë bërë viktimat pjesëmarrëse dhe
20 unë e dëgjova çfarë u tha këtu dhe që të jem i singertë,
21 pyetjeve të mia nuk u është dhënë një përgjigje e kënaqshme por
22 unë i kuptoj nga ana tjetër vështirësitë që kanë palët dhe
23 personat që janë të përfshirë këtu, si viktimat, dëshirojnë që
24 palët - domethënë që është në kundërshtim me atë që dëshirojnë
25 viktimat që palët të bëjnë.

1 Unë shpresoj që palët ta kuptojnë interesin e viktimave
2 dhe të kenë një ide të qartë për të ardhmen e këtyre
3 procedurave. Unë për momentin do ta lë këtu.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Pika tjetër në
5 rendin e ditës që ka të bëjë me hetimet e mbrojtjes. Desha të
6 dëgjoj nga mbrojtja në lidhje me hetimet që kanë bërë nëse për
7 shembull, në bazë të vlerësimeve kohore që ka bërë Prokuroria
8 për sa i përket procesit të nxjerrjes së materialeve, a mund të
9 japë mbrojtja më shumë informacione në lidhje me hetimet e tyre
10 për mundësinë hetimore unike dhe nëse mbrojtja ka ndërmend të
11 japë njoftim në lidhje me alibinë apo për përjashtim të
12 përgjegjësisë penale.

13 Në lidhje me këtë, vërej parashtrimet e bëra nga zoti
14 Thaçi dhe zoti Krasniqi se hetimet e mbrojtjes pengohen nga
15 pandemia që po vazhdon, nga redaktimet e shumta që i bëhen
16 materialeve dhe zbatimi i masave mbrojtëse.

17 Gjithashtu desha të dëgjoja edhe çfarë ka për të thënë
18 Zyra Administrative në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve,
19 masat mbrojtëse për dëshmitarët dhe mbështetjen që i jepet në
20 këtë drejtim.

21 Zoti Misetic.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju e parashtruar shumë qartë, i
23 nderuar Gjykatës, pozicionin tonë në këtë fazë. Ne në këtë fazë
24 nuk kemi ndërmend të bëjë ndonjë parashtrim në lidhje me
25 alibinë apo me mundësitë hetimore unike, por ruajmë të drejtën

1 për të bërë parashtime në lidhje me to më vonë.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Një pikë, sepse e përmendët
3 në parashtimin tuaj që prisni një parashtim nga Zyra
4 Administrative për një listë nga Zyra për Mbrojtjen dhe
5 Mbështetjen e Dëshmitarëve. Është diçka për të cilën jeni
6 lidhur direkt me Zyra Administrative apo -- e keni marrë këtë
7 listë apo jo?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, jemi lidhur me drejtpërsëdrejti
9 me Zyrën Administrative dhe kemi një takim që do ta bëjmë nesër
10 me ta.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Emmerson apo zoti
12 Kaufman?

13 Z. KAUFMAN: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Ashtu siç
14 e kemi parashtruar në parashtimin 315, mbrojtja e zotit Veseli
15 nuk mund të fillojë një hetim thelbësor dhe kuptimplotë deri sa
16 të ketë marrë të gjitha materialet nga ZPS-ja dhe çështjet e
17 juridiksionit dhe kushtetutshmërisë së janë ngritur në mocionet
18 në bazë të Rregullës 97(1). Mbrojtja e zotit Veseli nuk mund të
19 pritët të përcaktojë burimet pa e ditur se çfarë barre ka në
20 lidhje me provat inkriminuese. Po kështu, mbrojtja nuk duhet të
21 pritët të japë alibi deri sa të ketë të njëjtat informacione që
22 -- ku thuhet se ç'lidhje ka zoti Veseli me vendngjarjet e
23 krimeve.

24 Po kështu në lidhje me mundësitë hetimore unike, ne jemi
25 në të njëjtin mendim si mbrojtja e zotit Thaçi dhe do të japim

1 kërkesat e duhura në kohën e duhur.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Më
3 dëgjoni? Çështja që desha të ngre është kjo: Ju i nderuar
4 Gjykatës thatë që në fillim të kësaj seance që nesër mbrojtja
5 dhe Prokuroria mund të presim vendime në lidhje me
6 kundërshtimet tona në lidhje me juridiksionin dhe
7 kushtetutshmërinë dhe me sa kuptova, ju do të trajtoni çështjet
8 e ngritura jo vetëm nga mocion i vetëm dhe ndoshta për arsye që
9 mendoj se i kuptojmë të gjithë, ju i keni grupuar këto
10 parashtrimet nën tituj të caktuar dhe i keni grupuar dhe do t'i
11 trajtoni në një vendimin tuaj. Një diçka që vura re është që ju
12 i nderuar Gjykatës thatë që vendimet në lidhje me çështjet e
13 kushtetutshmërisë do të vijjnë gjatë kohës së pushimeve. Arsyeja
14 pse e ngre këtë është se është shumë me rëndësi në qoftë se
15 vendimet në lidhje me aktivitetet retrospektive të kaluara, që
16 e kemi ngritur në kundërshtimin tonë si ekip i mbrojtjes së
17 zotit Veseli, pra për diskriminim midis dëshmitarëve serbë dhe
18 shqiptarë dhe natyrës detyruese apo jo të Gjykatës Kushtetuese
19 Serbe dhe rrjedhojat e kësaj.

20 Arsye pse e them këtë është sepse sigurisht, në qoftë se
21 ne kemi të drejtë në lidhje me atë vendim të Gjykatës
22 Kushtetuese të Serbisë, atëherë çështja e zotit Veseli nuk
23 qëndron. Ajo do të përfundohet këtu. Pra Prokuroria ka thënë
24 hapur se nuk ka prova kundër tij, as për kryerje fizike të
25 krimeve dhe bashkëkryerje, as për ndihmë dhe inkurajim, apo

1 marrje pjesë në një mënyrë tjetër në këto krime. Dhe në qoftë
2 se vendimi i Gjykatës Kushtetuese serbe zbatohet për
3 protagonistët e tjerë në të njëjtin konflikt në Serbi, atëherë
4 do të ishte e drejtë që zoti Veseli të kthehej në Prishtinë
5 menjëherë dhe të jepej vendimi i pafajësisë së tij, si një
6 person i pafajshëm.

7 Arsyeja pse po pyes është që kur ju i nderuar Gjykatës
8 thatë që për këto dy aspekte ju do të jepni vendime nesër,
9 kurse vendimi i tretë nuk do të jepet deri nga mesi i pushimeve
10 të Gjykatës, duke qenë se kjo është një çështje që ka të bëjë
11 me kundërshtimin e juridiksionit të kësaj Gjykate dhe me
12 kundërshtimin e aktakuzës, me çështjet kushtetuese. Pra me
13 fjalë të tjera, nuk duhet të bëhet diskriminim në kuptimin që
14 të jepet një vendim për serbët dhe një vendim për shqiptarët.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Emmerson, unë nuk do
16 t'ju jap paraprakisht vendimin tim. Unë nuk do të them këtu
17 paraprakisht se çfarë vendimi do të jap më vonë.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Por a
19 mund të tregoni se si do të jetë vendimi në lidhje me çështjen
20 konstitucionale që ngritëm ne. Ky nuk do të jepet deri në
21 gusht?

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po, ashtu është, vendimin
23 tim do ta merrni kur të merrni vendimin me shkrim në lidhje me
24 këtë çështje.

25 Z. YOUNG: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Shumë

1 shkurtimisht. Është shumë e vështirë zoti Gjykatës që të jap
2 informacion të mëtejshëm në këtë fazë sepse nuk mund të
3 komentoj për çështjen e alibisë, nuk mund të komentoj për
4 çështjen e mundësive hetimore unike. Ne jemi penguar shumë nga
5 masat e mëdha mbrojtëse që janë dhënë, nga redaktimet e shumta,
6 nga mungesa e dosjes paraprake dhe për ta vënë këtë në një
7 kontekst të përgjithshëm në lidhje me zotin Selimi, ne duhet të
8 themi që tani kemi vetëm një numër shumë-shumë të vogël akuzash
9 për akte personale të cilat janë parashtruar kundër tij. Dhe
10 duke pasur mungesë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët,
11 atëherë këto çështje nuk mund të ngrihen kundër tij brenda
12 kësaj gjykate.

13 Zonja Alagendra.

14 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Nuk
15 kam asgjë për të shtuar. Ne jemi dakord me çfarë thanë kolegët.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] T'i kthehem Prokurorisë.
17 Keni ndonjë parashtrim në lidhje me këtë?

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për të qenë të vërtetë dhe të
19 saktë në parashtrime, deklarata e bëra nga zoti Emmerson
20 qartësisht nuk janë të sakta. ZPS-ja nuk ka bërë lëshime të
21 tilla. Akuzat me format e përgjegjësisë janë të parashtruara në
22 aktakuzë dhe qëndrojnë. E vetmja gjë që ka treguar ZSP-ja në
23 mënyrë faktike është që mënyra faktike është ajo që është
24 reflektuar në aktakuzë.

25 Siç është në dijeni edhe mbrojtja, kjo procedurë paraprake

1 po arrin një fazë të përparuar. Tashmë, nxjerrja e materialeve
2 që kanë mbetur dhe të cilat ZPS-ja synon të përdorë në gjykim
3 është duke u përfunduar në mënyre të konsiderueshme. Unë i kam
4 trajtuar edhe më përpara deklaratat e gabuara që ka bërë
5 mbrojtja për hetimet në zhvillim e sipër të ZPS-së, si të tilla
6 që pengojnë fillimin e procesit gjyqësor.

7 Në mënyrë të ngjashme, ekipet e mbrojtjes orvaten që të
8 paraqesin sikur Prokuroria nuk është e gatshme për ta filluar
9 gjykimin e kësaj çështjeje. Për këtë ata sjellin si ilustrim
10 procesin e nxjerrjes së materialeve. Sigurisht ka arsye të
11 mirëditura dhe të dukshme përse kjo nxjerrje nuk mund të bëhet
12 përpara momenteve të caktuara. Këto arsye kanë të bëjnë me
13 dijeninë lidhur me objektin e akuzave të konfirmuara për të
14 ndihmuar në identifikimin e materialeve përkatëse si edhe
15 regjimin e redaktimeve që do të përdoret. Këto janë aspekte të
16 cilat mund të zgjidhen përpara Panelit, në rast se do të ishte
17 e dobishme që të kujtonim të gjitha palëve se brenda gjashtë
18 javëve pas paraqitjes së parë, mbrojtjes i janë vënë në
19 dispozicion mbi 1800 materiale provuese, përfshirë edhe
20 deklaratat e rreth 130 dëshmitarëve si edhe një përmbledhje e
21 hollësishme prej 600 faqesh e materialeve përkatëse. Pas këtij
22 momenti është vijuar nxjerrja deri në këtë javë për të cilën
23 flasim. I nderuari Gjykatës ka vendosur kalendarin e nxjerrjes
24 së materialeve në këtë çështje dhe ZPS-ja i ka respektuar këto
25 afate duke bërë disa kërkesa të kufizuara për një vëllim të

1 kufizuar materialesh.

2 E kam përmendur këtë, por i vetmi faktor që ka ndikim më
3 të konsiderueshëm për sa i takon përcaktimit të momentit të
4 nxjerrjes në këtë rast, është kriteri për nënkategorizimin
5 shtesë, gjë e kërkuar nga pala mbrojtëse. Sigurisht është
6 përmendur edhe efekti që kanë masat mbrojtëse por ato masat të
7 cilat janë miratuar kanë qenë të nevojshme duke pasur parasysh
8 rreziqet objektive. Por unë mendoj se ja vlen të përmendet se
9 një sasi e konsiderueshme e provave tashmë i janë nxjerrë
10 mbrojtjes ose janë duke ju nxjerrë mbrojtjes. Këto janë
11 materiale të cilat ose nuk kanë pasur nevojë për redakte ose
12 kanë qenë me redakte standarde. Për shembull, afërsisht 170
13 dëshmitarë në këtë çështje për të cilët nuk është bërë shtyrje
14 e nxjerrje së materialeve, provat e të cilëve mbrojtja tashmë i
15 ka marrë ose është duke i marrë.

16 Krahës kësaj, janë nxjerrë ose janë duke u nxjerrë pa
17 redakte edhe një sasi shumë e madhe provash kryesore ose në
18 materiale video. Bëhet fjalë për një vëllim të konsiderueshëm,
19 prandaj edhe njëherë do të thosha se nuk qëndron sugjerimi se
20 hetimet e palëve po pengohen ose po parandalohen nga procesi i
21 nxjerrjes apo të masave mbrojtëse.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Mbrojtja, dëshiron të marri fjalën? Zoti Misetic?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Më duket sikur po jetojmë në një
25 univers paralel se ku qëndron faza e ekipeve mbrojtëse dhe ku

1 performon Prokuroria. Unë edhe një herë e ri theksoj se 200
2 dëshmitarë, identitetin e të cilëve ne nuk e dimë, 30 ditë
3 përpara gjykimit nuk është diçka e cila do të na ndihmonte në
4 përgatitjet e mbrojtjes. Pra, ne pengohemi pikë së pari nga
5 regjimi i masave mbrojtëse në këtë çështje, së dyti sa i takon
6 nxjerrjes, ne, gjithsesi e përsëris na mbeten ende materiale që
7 duhet të marrim, por na thuhet se performanca e Prokurorisë
8 këtu më duket se fjala që u përdor ishte e jashtëzakonshme. Nga
9 transkriptimi i Konferencës për Ecurinë e Çështjes së datës 18
10 nëntor të vitit 2020 ju është thënë se:

11 "Sipas këndvështrimit të ZPS-së nuk ka asnjë arsye pse
12 gjyqi i kësaj çështje të mos fillojë në verën e vitit 2021."

13 Tani, a ka arsye objektive që i shkaktojnë probleme ZPS-së
14 apo jo nuk e di, nuk dua që të hedh dyshime mbi vështirësitë
15 objektive që mund të ketë ZPS-ja për përmbushjen e këtij afati.
16 Por që të na portretizojë ne si mbrojtje e cila paraqet një
17 pamje tjetër, mendoj se është një shtrembërim i realitetit të
18 kësaj çështjeje. Ne nuk jemi gati për gjykim sepse ZPS-ja nuk
19 na ka nxjerrë të gjitha materialet. Ne kërkojmë që të jepen
20 materialet e Rregullës 95(4) brenda tetorit dhe për këtë ruajmë
21 rezerva sepse ende nuk jemi të sigurt nëse do të përmbushen
22 këto afate apo jo.

23 Në këto rrethana ne nuk jemi të gatshëm që të angazhohemi
24 sa i takon një afati për përgatitjen e një dosje paraprake nga
25 ana jonë për ju. Faleminderit i nderuar Gjykatës.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Misetic.
2 Nuk shoh ndonjë kërkesë tjetër për të marrë fjalën. Kalojmë në
3 pikën tjetër në rendin e ditës që janë pikat juridike dhe
4 faktike për të cilat palët pajtohen. U lutem palëve që të
5 tregojnë nëse presin që të identifikojnë një listë të pikave që
6 janë objekt mosmarrëveshjeje dhe një listë të pikave që nuk
7 janë objekt mosmarrëveshjeje. Në këtë aspekt vërej atë që ka
8 thënë mbrojtja e zotit Krasniqi se është arritur marrëveshje
9 për katër pika faktike sa i takon bekgraundit të zotit
10 Krasniqi. Po kështu vërej edhe parashtrimin e zotit Thaçi se do
11 të komentojë për këto aspekte pasi ZPS-ja të ketë përfunduar
12 hetimet e veta dhe t'i ketë vendosur në dispozicion të
13 mbrojtjes dosjen paraprake.

14 Zonja Prokurore, fjala për ju.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk kemi asgjë
16 për të shtuar për këtë. Sigurisht mbrojtja e zotit Krasniqi ka
17 bërë të ditur pajtimin mbi katër pikat faktike, mbi të dhënat
18 biografike të zotit Krasniqi. Asnjë prej ekipeve të tjera të
19 mbrojtjes nuk i janë përgjigjur Prokurorisë jashtë
20 parashtrimeve që ata kanë bërë në kuadër të Konferencave mbi
21 Ecurinë e Çështjes. Faleminderit.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Ndonjë prej ekipeve të mbrojtjes dëshiron të shtojë diçka
24 lidhur me parashtrimet e tyre të mëparshme që kanë bërë në
25 Konferencat për Ecurinë e Çështjes apo parashtrime të tjera me

1 shkrim?

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] I nderuar
3 Gjykatës, në emër të zotit Veseli, ne e kemi bërë të qartë
4 qëndrimin tonë. Është i njëjtë edhe me qëndrimin e zotit Thaçi.
5 Ne nuk do të orvatemi që të bëjmë diçka deri sa të kemi marrë
6 dosjen paraprake të Prokurorit.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

8 Zoti Young?

9 Z. YOUNG: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Thjesht për
10 të thënë se mbështes atë që tha zoti Emmerson dhe ekipi i zotit
11 Thaçi.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Z. Misetic, keni diçka për të thënë? Jo? Në rregull.

14 Kalojmë tani në pikën tjetër në rendin e ditës që ka të
15 bëjë me mbajtjen në paraburgim. Dua që Zyra Administrative të
16 na japë një përditësim lidhur me komunikimin midis avokatëve të
17 mbrojtjes dhe klientëve dhe regjimit të mbajtjes në paraburgim.

18 Sa i takon shkëmbimit të dokumenteve midis avokatëve të
19 mbrojtjes dhe të akuzuarve dhe nëse është përmirësuar kjo në
20 objektin e paraburgimit si edhe një përditësim sa i takon
21 rregullave për Covid-19 dhe nëse kanë rifilluar apo jo vizitat
22 e familjarëve në korrik.

23 Zyra Administrative është shprehur se janë bërë
24 përmirësime në sistemin elektronik të shkëmbimit të dokumenteve
25 dhe se kanë rifilluar takimet nga afër midis avokatëve dhe të

1 akuzuarve.

2 U kërkoj palëve që të thonë se cilat janë masat më të
3 fundit që janë marrë dhe nëse këto u përgjigjen shqetësimeve të
4 tyre.

5 Zyra Administrative në fillim.

6 ZYRA ADMINISTRATIVE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
7 Gjykatës. Sa i takon pyetjeve që ka bërë avokati i mbrojtjes së
8 zotit Thaçi për disa kufizime për vizitat e bëra nga mbrojtja,
9 dua të konfirmoj se praktika përpara Covid ka qenë për të
10 lejuar katër anëtarët e ekipeve në vizitat e privilegjuara.
11 Kufizimi për katër persona ka të bëjë me madhësinë e dhomës.
12 Krahas kësaj, është gjithmonë mundësia që të shtohet një ose më
13 shumë anëtarë të tjerë përmes lidhjes telefonike.

14 Në bazë të këshillës së zyrtarit mjekësor, kufizimi aktual
15 tani për vizitat nga afër është tre persona, në vend të katër
16 vizitorëve të privilegjuar. Jemi në dijeni të një kërkesë që
17 është bërë nga fundi i majit për të shtuar dhe një ekip të
18 tretë të mbrojtjes për një vizitë të privilegjuar për zotin
19 Thaçi. Asokohe kjo kërkesë nuk mund të plotësohej. Besojmë se
20 kjo ishte për shkak të masave kundër Covid-19 në bazë të
21 këshillës së marrë nga zyrtari mjekësor.

22 Dua që të theksoj se në maj vizitat e avokatëve nga afër
23 bëheshin ende me një dritare ndarëse në mes në dy dhoma të
24 veçanta. Nuk ishte ideale por kjo ishte e diktuar nga situata e
25 Covid-19. Në të njëjtën kohë, vizitat me video nga larg janë

1 afruar dhe vijnë që të ofrohen.

2 Duke filluar nga ky muaj, pra nga muaji korrik, vizitat
3 mund të bëhen në të njëjtën dhomë, duke pasur vetëm një ndarëse
4 prej peksiglasë midis vizitorëve dhe të ndaluarit.

5 Që t'ju japim një ide, janë të ngjashme me këto panele
6 ndarëse peksiglasë si këto që janë këtu në sallën e gjyqit.

7 Sa i takon çështjes së transmetimit të dokumenteve që
8 përmendët ju, por më duket se është përmendur edhe nga avokati
9 i zotit Thaçi, do të doja që të theksoja se gjithmonë ka qenë e
10 mundur kur avokati ka qenë i pranishëm në të njëjtën dhomë me
11 të akuzuarin, që t'i jepeshin kopje fizike të dokumenteve.

12 Por duke filluar nga muaji korrik ekipet juridike mundet
13 që të shkëmbejnë dokumente të printuara, sigurisht.

14 Nëse mund të them, është futur në funksionim në sistemin
15 SEDS një server i skedarëve. Kjo ka ndodhur në mars të vitet
16 2021 për të mundësuar shkëmbimin digjital të dokumenteve midis
17 ekipeve të mbrojtjes dhe të ndaluarve. Ka pasur disa probleme
18 fillimisht, por sigurisht që është punuar që të vihet në
19 funksionim sa më mirë kjo, janë zgjidhur. Pas muajit mars është
20 rritur kapaciteti ruajtës për shkëmbimin e këtyre dokumenteve
21 nga ekipet e mbrojtjes në sistem, në sistemin SEDS e kam
22 fjalën, aktualisht, po shikojmë që ta shtojmë edhe më shumë
23 këtë kapacitet. Edhe sa i takon vizitave të familjarëve, kam
24 kënaqësi që të konfirmoj se falë lehtësimit të masave kundër
25 pandemisë nga data 15 korrik kanë rifilluar vizitat e

1 familjarëve, siç pritej.

2 Zyra Administrative mbështet në aspektet logjistike. Që
3 sot besoj se të gjithë akuzuarit kanë përfituar nga vizita të
4 tilla. Ne do të vijojmë që të mbështesim këtë dhe do t'i bëjmë
5 të mundshme gjithnjë duke pasur parasysh zhvillimin e pandemisë
6 së Covid-19.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë. Tani po
8 i drejtohem Mbrojtjes.

9 A ka ndonjë ekip nga mbrojtja që dëshiron të flasë për
10 këto çështje dhe nëse ka ndonjë problem të pazgjidhur në lidhje
11 me vizitat.

12 Zoti Young

13 Z. YOUNG: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Shumë
14 shkurt, siç e dini, ne po ndjekim çështjen e lirimit të
15 përkohshëm të zotit Selimi. Por dua të falënderoj Zyrën
16 Administrative që ka përmirësuar mundësitë për shkëmbimin e
17 informacionit dhe ky qe zhvillim progresiv. Falënderoj këtë
18 zyrë për lehtësimin e takimeve personale fizike, që përmirëson
19 shumë mundësitë tona. Këtë desha të thosha. Faleminderit.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Young.

21 Zoti Misetic.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
23 Po, edhe ne e konfirmojmë marrëveshjen me parashtimin që bëri
24 Zyra Administrative por ka akoma një kufizim lidhur me numrin e
25 njerëzve që mund të bëjnë vizita dhe që e pengojnë edhe

1 komunikimin tonë sepse na duhet gjithmonë të kemi një përkthyes
2 por siç tha kolegu janë përmirësuar kushtet. Faleminderit.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk shoh që të kërkojë njeri
4 tjetër fjalën nga mbrojtja. Kështu që mund të vazhdojmë me
5 temën tjetër.

6 Falënderoj Zyrën Administrative për gjithë përpjekjet që
7 ka bërë si lidhur me komunikimin midis klientëve dhe
8 mbrojtësve, por edhe për vizitat familjare.

9 Përpara se t'ua jap fjalën palëve për datën e Konferencës
10 së ardhshme, vë re se mbrojtja e Krasniqit, Selimit, Veselit
11 kanë bërë një apelim kundër vendimit për rishikimin e
12 paraburgimit.

13 Dua t'i pyes këto ekipe mbrojtjeje nëse synojnë të
14 kërkojnë shtyrjen e shqyrtimit tjetër të paraburgimit të të
15 akuzuarve, pas daljes së vendimit të Gjykatës së Apelit
16 sikundër kërkuan gjatë apelimit të fundit për paraburgimin apo
17 duan që ta rishqyrtoj unë paraburgimin dy muaj pas shqyrtimit
18 tim të fundit?

19 Po i drejtohem ekipit të zotit Krasniqi, sepse është ekipi
20 i parë që ka bërë këtë apelim. Zonja Alagendra.

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Duam
22 të kërkojmë një shtyrje deri sa të mbarojë apelimi.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në të njëjtat modalitete?

24 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Po, i
25 nderuar Gjykatës.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja

2 ALAGENDRA.

3 Apelimi i dytë është për zotin Selimi. Zoti Young.

4 Z. YOUNG: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes]

5 Shkurtimisht, kërkoj 24 orë që ta rishqyrtojmë qëndrimin dhe

6 t'ju kthejmë përgjigje .

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po mund ta bëni këtë nesër.

8 Z. YOUNG: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes]

9 Faleminderit.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Young.

11 Dhe mbrojtja e zotit Veseli. Zoti Emmerson.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Më falni

13 se e kisha heshtur. Nuk kërkojmë zgjatje. Kërkojmë që të

14 vazhdoni të shqyrtoni detyrimin që keni për rishikimin e

15 paraburgimit sipas periudhës ligjore.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani dua të dëgjoj mendimin

17 e palëve për një datë të përshtatshme për Konferencën e

18 ardhshme për Ecurinë e Çështjes, duke qenë se Trupi Gjykses 1

19 do të fillojë gjykimin e Çështjes 05 në shtator. Salla e gjyqit

20 nuk do të jetë e disponueshme atë ditë, prandaj propozoj që

21 konferencën e ardhshme ta zhvillojmë në 13 shtator të hënën,

22 apo të martën në 14 shator, në orën 14:30 që do të ishte kohë e

23 përshtatshme për t'ju përshtatur kërkesave të mbrojtësve sipas

24 vendeve të ndryshëm ku ata janë.

25 Zonja Prokurore.

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Prokuroria është e gatshme të jetë
2 e disponueshme në të dy datat që propozohen.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
4 Prokurore.

5 Zoti Misetic.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Mbrojtja e Thaçit është
7 disponueshme në të dyja datat, gjithashtu.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Misetic.
9 Zoti Emmerson.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Edhe për
11 ne në rregull është.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Young?

13 Z. YOUNG: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Edhe për ne
14 është në rregull.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zonja Alagendra?

16 Mikrofonin, hapeni.

17 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] E
18 njëjta gjë edhe për ne.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
20 ALAGENDRA.

21 Zoti Laws?

22 Z. LAWS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Unë kam një
23 vështirësi sepse kam një punë në Mbretërinë e Bashkuar dhe nuk
24 do të isha i disponueshëm. E kuptoj se gjyqi fillon në 15
25 kështu që nuk propozoj që të shtyhet përtej datës 14. Them se

1 do të bëj ç'është e mundur që të jem i disponueshëm.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, e vlerësojmë
3 shumë. Besoj që Zyra Administrative nuk ka ndonjë problem me
4 asnjë prej këtyre datave? Faleminderit shumë.

5 Si gjithmonë, i ftoj palët të bëjnë parashtime me shkrim
6 nëse duan të ngrenë ndonjë çështje konkrete gjatë Konferencave
7 për Ecurinë e Çështjes dhe do të merrni njoftimet përkatëse
8 bashkë me axhendën.

9 Tani, i pyes palët nëse kanë ndonjë çështje tjetër që
10 dëshirojnë ta ngrenë dhe të japin njoftim paraprak nëse kanë
11 ndonjë parashtim për të cilin kërkohet seancë e mbyllur, pra
12 ka informacion konfidencial.

13 Zonja Prokurore.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, faleminderit, i nderuar
15 Gjykatës.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

17 Zoti Misetic?

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Zoti Emmerson?

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Nuk kemi
21 asgjë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Emmerson.

23 Zoti Young?

24 Z. YOUNG: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] S'kemi
25 asgjë, as ne.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zonja Alagendra?

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] Nuk
3 kemi asgjë, falemnderit.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Laws, ju lutem?

5 Z. LAWS: [Përkthim] [nëpërmjet videolidhjes] S'kemi asgjë
6 as ne.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Laws.

8 Përpara se të përfundojmë këtë seancë, do të lëshoj dy
9 urdhra gojorë. Urdhri i parë me gojë ka të bëjë me afatin e
10 ZPS-së për materialet e Rregullës 102(b), nën dritën e kërkesës
11 për redakte dhe për miratimet dhe vonesën e raportit të
12 ekspertëve, e ndryshoj afatin për nxjerrjen e materialeve të
13 Rregullës 102(1)(b) për 27 shtator 2021.

14 Do të lëshoj urdhrin e dytë me gojë për afatin kohor për
15 shqyrtimin tjetër të paraburgimit të zotit Krasniqi, pasi të
16 kem dëgjuar nga palët. Urdhëroj mbrojtjen e zotit Krasniqi të
17 bëjë parashtrime nëse ekzistojnë ende arsyet për vazhdimin e
18 paraburgimit, dhjetë ditë pas njoftimit të vendimit të Panelit
19 të Gjykatës së Apelit për apelin kundër vendimit të Gjykatësit
20 të Procedurës Paraprake që refuzon lirimin e përkohshëm.
21 Përgjigjet dhe kundër-përgjigjet do të ndjekin afatet e
22 parashikuara në Rregullën 20/76 të Rregullores.

23 Në qoftë se mbrojtja vendos të mos bëjë asnjë parashtrim
24 në afatin kohor të parashtruar, ZPS-ja do të bëjë parashtrimet
25 e saj për shqyrtimin e mëtejshëm të paraburgimit dhjetë ditë

1 pas përfundimit të afatit. Përgjigjet, kundër-përgjigjet do të
2 ndjekin afatet e përcaktuara në Rregullën 76 të Rregullores.

3 Këtu përfundon urdhri im i dytë. Këtu përfundon edhe
4 seanca jonë e sotme. Falënderoj palët, pjesëmarrësit, dhe si
5 gjithmonë falënderoj përkthyesit, stenografët, teknikët, dhe
6 personelin e sigurisë për pjesëmarrjen. Seanca përfundon këtu.

7 Të gjithë në këmbë.

8 --- Seanca e Konferencës për Ecurinë e Çështjes
9 mbyllet në orën 17:19

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25